

# Dukagjini "Nderi i Kombit"



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetae "Dukagjini", Viti i XIX i botimit, nr. 219, Janar 2022

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## GJENERAL PETRIT ÇUNI, "NDERI I SHOQATËS ATDHETARE DUKAGJINI"

Me dekret të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, nr. 13 346, datë 26 nëntor 2021, Kolonel Petrit Çuni, me detyrë "Përfaqësues Ushtarak Kombëtar" në Përfaqësinë Ushtarake Jashtë Vendit, në Ministrinë e Mbrojtjes, i jepet grada madhore "Gjeneral Brigade". Kolonel Petrit Çuni (tani, Gjeneral Brigade Petrit Çuni), me datën 08 korrik 2019 deri me datën 15 korrik 2022, është emëruar në detyrën Përfaqësuesi i Lartë Ushtarak Kombëtar, në Komandën Strategjike të NATO-s, në Mos Belgjikë.



## NJË DITË PLOT EMOCION E KRENARI

### Mhill Çun Gjonaj - "Mjeshtër i Madh"

Në kuadrin e vlerësimit të disa figurave të shquara në fushën e kulturës, artit dhe sportit, Shkëlqesia e Tij, Presidenti i Republikës, Z. Ilir Meta, ditën e Enjte, më 20 Janar 2022, ishte në Shkodër, i pranishëm në një ceremoni, në të cilën akordoi dekorata i tituj nderi, për një numër jo të vogël artistësh, në gjithë kuptimin e fjalës, duke filluar nga urdhri "Nderi i Kombit", që iu dha bilbilin të këngës popullore Shkodrane, Shyqyri Alushi (pas vdekjes), e deri tek "Mjeshtër i Madh", me të cilin u nderua kujtimi, emri dhe vepra e letrartit të njohur pa përsëritshme të Folklorit Shkodran në të gjitha dimensionet e veta...



## EDICIONI I 10-të: PERSONALITET E

### VITIT 2021

(Best-North-Buna 1-10-2021)

Me datën 20 janar 2022, dite e Enjte, në orën 18.00, në Teatrin "Migjeni", u zhvillua ceremonia e Natës Finale e personaliteteve të vitit 2021 për Shkodrën.

Një organizim i shkëlqyer nga Presidenti i spektakleve "Buna 1", nga zoti Arben Mazi. Kjo veprimtari prezantuese e votuese ka filluar me datën 10 dhjetor 2021 deri me datën 10 janar 2022, për personalitete në tetë fusha të ndryshme: mësuesi më i mirë; humoristi më i mirë; këngëtarë më i mirë; sportisti më i mirë; piktori më i mirë; letërsi më i mirë; shkrimtari ...



## SOFRA E DUKAGJINIT- 2022

Me 28 Dhjetor 2021, në ambientet e Bar Restorant "Antika" u mbajt "Sofra e Dukagjinit-2022". Kjo datë është tashmë tradicionale dhe personifikohet si data e mbajtjes së ngjarjes më të rëndësishme folklorik të vitit. "Sofra" erdhi si një veprimtari pas një viti pushim për shkak të situatës në të cilën e gjithë bota po ndodhet, ajo e covid-19. E duket se të gjithë i kishte marrë malli për këtë organizim.

Si gjithmonë u mbajt nën udhëheqjen artistike të z. Lulash Brigja, i cili ishte kujdesur që nga përmbajtja artistike të mos i mungonte asgjë. E njëjta gjë për mjedisin, skenën, organizimin e publikut, që të kishin gjithë komoditetin e mundshëm të pronari i Bar Restorant "Antika", dhe njëkohësisht edhe drejtori tashme Shoqatës "Sofra e Dukagjinit", z. Vuksan Xhuri. I gjithë veprimtaria filloi në orën 15:00, nën moderimin e znjsh. Klodjana Serraj, e cila për të disaten vit radhazi është pjese e prezantimit të "Sofrës së Dukagjinit", dhe këtë vit për here të parë iu bashkua në modë edhe znjsh. Pamela Mirashi. Me muzikën me fyell, si në ambiente ...

## RRON TRADITA NË MALËSI TË MADHE

Më ka mbetur në mendje një shprehje e mënçur, e cila thotë se: "Sekreti i suksesit është këmbëngulja për arritjen e qëllimit", gjë për të cilën mund të them me bindje se, në veprimtarinë e datës 20 dhjetor 2021, në Bregun e "Shpellës së Frashnit", SUKSESI u finalizu mrekullisht bukur.

Një veprimtari edukative e veshur me një dinamikë vlerash kulturore, disi të fjetura në këtë kohë evolucionit ndërkulturor, bënë që jehona e saj të marrë dhenë e të shpërndahet si era bjeshkëve të malësisë. Një sukses që nuk përshkruhet me fjalë, në të cilin pata fatin të jem njëri nga prezantuesit e tij. Një mundësi dhe surprizë e bukur nga e cila mora jo vetëm kënaqsi, por edhe motivim të vijoj pa u ndalur dhe me vetbesim, rrugën në time drejt suksesit.

Një veprimtari e mirëorganizuar, të cilin fare mirë mund ta quaj si një punë e mirëfilltë institucionale pas së cilës qëndrojnë organizator profesionist. Ku për hirë të vërtetës, kjo veprimtari ishte një realizim i Shoqatës Kulturore "Xhubleta e Shqipërisë" në bashkëpunim me Gjimnazin "Dodë Kaçaj" Bajzë, ...

# GJENERAL PETRIT ÇUNI, “NDERI I SHOQATËS ATDHETARE DUKAGJINI”

Me dekret të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, nr. 13 346, datë 26 nëntor 2021, Kolonel Petrit Çuni, me detyrë “Përfaqësues Ushtarak Kombëtar” në Përfaqësinë Ushtarake Jashtë Vendit, në Ministrinë e Mbrojtjes, i jepet grada madhore “Gjeneral Brigade”.

Kolonel Petrit Çuni (tani, Gjeneral Brigade Petrit Çuni), me datën 08 korrik 2019 deri me datën 15 korrik 2022, është emëruar në detyrën Përfaqësuesi i Lartë Ushtarak Kombëtar, në Komandën Strategjike të NATO-s, në Mos Belgjikë.

## Kush është Gjeneral Petrit Çuni?

Petrit Çuni lind me 6 Shtator 1969, në fshatin Gimaj, krahina e Shalës, zona e Dukagjinit, Shkodër, djali i Pal e Tone Çuni, banon në Tiranë.

Gjeneral Petrit është i martua, me Eg-lantinen (me profesion psikologe) dhe kanë tre fëmijë, vajzen Antonelen e date-lindjes shtator 2019, djalin Paulon dhe djalin Etritin.

## Kualifikimi:

- 1984-1988, Shkolla e Mesme e Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej” Tiranë;
- 1988-1992, Akademia e Forcave Tokësore “Skënderbej” Tiranë, specialiteti Tanke/Teknik;
- Maj 96-Shkurt 97, Ndjekur Kursin e Gjuhës Gjermane pranë ATF Tiranë;
- Prill-Shtator 1997, Praktikën e trupave dhe Kursin e Komandantit të Batalionit (Shkolla e Tankeve në Munster Gjermani);
- Tetor-Dhjetor 2000, KTHOSH Kursin Themelor të Oficerit të Shtabit në Akademinë e Mbrojtjes Tiranë;
- Prill-Qershor 2004, Kursin intensiv të gjuhës Angleze Nivel i pare në Brigadën e Reagimit Shpejtë Tiranë;
- Shtator-Dhjetor 2005, Kurs intensiv për gjuhën Angleze në Q. Gj. Huaja Brigadën e Reagimit Shpejtë Tiranë;
- Janar-Qershor 2007, Kursin e Gjuhës

Angleze në Shkollën e Gjuhës Angleze CFLS (Canadian Force Language School) Nivel i Dytë Base Borden ONTARIO, KANADA;

- Nëntor 2007-Qershor 2009, Studime në Akademinë e Drejtimit Gjermani (Kursin e Gjeneralëve / Admiraleve me pjesëmarrje Internacionale / Bundeswehr Leadership Academy in Hamburg; Qershor-Korrik 2009, Kursin për Sigurinë Europiane (Eurokurs) në Akademinë e Drejtimit Gjermani;
- Shtator-Dhjetor 2010, Studime “Programi për studime të avancuara të sigurisë lartë”, në Qendrën George C. Marshall Gjermani;
- Prill-Korrik 2011, Kursi gjuhës Angleze Nivel i 3/2/3/2 në QGJH AM “SPIRO MOISIU” Tiranë; Shtator 2011, Seminar: “Aspektet ligjore të Krimit Kibernetik dhe të Ligjit Humanitar Ndërkombëtar”, Zyra e ODC Tiranë;
- Tetor 2015, Kursin orientues për stafi në NATO-s (NATO Staff Orientation Course) në shkollën e NATO-s Oberammergau Gjermani;

## Karriera

- Me 15 Korrik 1992, është titulluar Oficer;
- Në muajin Gusht 1992-Nëntor 1993; Zv. Komandant Kompanie në Batalionin e Tankeve në D17K Bajram Curri;
- Në muajin Nëntor 1993-Tetor 1995, Komandant i Batalionit të Tankeve në D17K, në Bajram Curri;
- Në muajin Nëntor 1995-Mars 1997, Komandant i Kompanie Tankesh në D17K, në Bajram Curri;
- Në muajin Prill 1997-Tetor 1997, Kualifikim në Republikën Federale Gjermane;
- Në muajin Nëntor 1997-Nëntor 1998,



Komandant Kompanie Tanke në b2t BrT D1K Shkodër;

- Në muajin Nëntor 1998-Shkurt 2001, Komandant Batalioni Tanke (gatshëm), në Brigadën e Tankeve, Melgushë, Shkodër;
- Në muajin Mars 2001-Qershor 2003, Komandant Kompanie Tanke në Brigadën e Këmbësorisë, në Melgushë Shkodër;
- Në muajin Korrik-Nëntor 2003, Shef i Operacioneve e Stërvitjes (S3) në blk, Brigada e Reagimit Shpejtë Shkodër;
- Në muajin Nëntor 2003-Nëntor 2007, Zv/Komandant në blk Brigada e Reagimit Shpejtë (BrRSH).
- Gjate kësaj periudhe: Tetor 2004-Maj 2005 & Shkurt 2006-Maj 2006, Komandant i Kontingjentit Paqeruajtës Shqiptare në Bosnie & Herzegovin (BiH);

- Në muajin Nëntor 2007-Korrik 2009, me Studime në Akademinë e Drejtimit Gjermani / Bundeswehr Leadership Academy in Hamburg;
- Në muajin Shtator 2009-Prill 2010, Zv/Komandant i Universitetit Ushtarak “SKËNDERBEJ” Tiranë;

- Në muajin Maj 2010-Tetor 2011, Zv/Komandant, Ai dhe për arsimimin Akademinë Ushtarake “SKËNDERBEJ” Tiranë;

- Në muajin Nëntor 2011-Shtator 2012, Komandant i Akademisë Ushtarake “SKËNDERBEJ” Tiranë;

- Në muajin Tetor 2012-Korrik 2013, Pedagog Përgjegjës i Kursit Lartë të Oficerit, Akademia e Forcave të Armatosura Tiranë;

- Në muajin Gusht 2013-15 Korrik 2016, Shef i Degës së Menaxhimit e Mbështetjes së Bazës & Përfaqësues Ushtarak i RSH në NATO Komandën e Forcës Bashkuar të NATOS Brunssum Holande;

- Me 15 Korrik 2016 e në vijim, Drejtor i NATO-s, BE dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Ministrinë e Mbrojtjes.

- Me 16 shkurt 2017 – 15 maj 2018, Shef i Shtabit i Forcës Tokësore Zall-Herr, Tiranë.

- Me 16 maj 2018 – 08 korrik 2019, Drejtor i Shtabit të Përgjithshëm / Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.

- Me 08 korrik 2019 e në vijim, Përfaqësues Ushtarak Kombëtarë, në Komandën Strategjike të NATO-s (ACO SHAPE), në Mos Belgjikë.

*Një karriere ushtarak, e shkëlqyer!*

## Gradimet:

- Në vitin 1992, gradën Nëntoger;
- Në vitin 1994, gradën Toger;
- Në vitin 1995, gradën Kapiten i Parë;



# NJË DITË PLOT EMOCION E KRENARI

## Mhill Çun Gjonaj - "Mjeshtër i Madh"

Në kuadrin e vlerësimit të disa figurave të shquara në fushën e kulturës, artit dhe sportit, Shkëlqesia e Tij, Presidenti i Republikës, Z. Ilir Meta, ditën e Enjte, më 20 Janar 2022, ishte në Shkodër, i pranishëm në një ceremoni, në të cilën akordoi dekorata i tituj nderi, për një numër jo të vogël artistësh, në gjithë kuptimin e fjalës, duke filluar nga urdhri "Nderi i Kombit", që iu dha bilbililit të këngës pupullore Shkodrane, Shyqyri Alushi (pas vdekjes), e deri tek "Mjeshtër i Madh", me të cilin u nderua kujtimi, emri dhe vepra e legjendës së pa përsëritshme të Folklorit Shqiptar, në të gjitha dimensionet e veta, (si poet, muzikant, instrumentist dhe këngëtar, Mhill Çun Gjonaj (pas vdekjes).

Ndonëse i vonuar, ky titull e ky vlerësim, bëri krenar familjen, të afërmit, miqtë e tij të shumët (në mes të cilëve jam dhe unë, prej më shumë se dyzet e pesë vjetësh), Shoqatën Atdhetare "Dukagjini" dhe kryetarin e saj Z. Ndue Sanaj, që e propozoi, promovoi dhe realizoi dhënien e këtij urdhri.

Titulli i lartë "Mjeshtër i Madh", dhënë birit të lavdishëm të Shalës, Dukagjinit dhe gjithë veriut të Shqipërisë, Mhill Çun Gjonaj (pas vdekjes), nga Presidenti i Republikës, iu dorëzua në mes duartrokitjeve dhe emocioneve, që shkaktoi prezencën dhe fjalën e saj, vajzës së Tij të madhe, Zj. Kristiana Gjonaj-Çinarja.

### Kush ishte Mhill Çun Gjonaj?

Mhilli, lindi me 18 shtator 1950, në fshatin Breglumi, të krahinës së Shalës, në një familje të nderuar në Dukagjin, Çun Nika e Drane Markja.

Shkollën fillore e 8 vjeçare i përfundoi në fshatin e lindjes. Pastaj vijoje shkollën e mesme për veterinar, në shkollën Pro-



fesionale Veterinare – Shkodër. Por ai, kishte një dhunti në një fushë tjetër, në atë të folklorit dhe jo vetëm për të kënduar, por dhe për të krijuar tekste të veçanta për kohën.

Pra, Mhilli u bë rapsod dhe kantautor më me emër në gjitha trevat shqiptare: Kryerapsodi i Dukagjinit më i spikatur i të gjitha kohërave dhe pa dyshim një nga zërat më autentik të çiftelisë në shkallë kombëtare.

Mhill Çuni dhe Sali Mani ngjitën si askush në pedestal këngën rapsodike Dukagjinase dhe të Malësisë së Madhe duke formuar së bashku bigën ma të lartë të flokut të çiftelisë në veri të Shq-

ipërisë. Mhilli, ishte një mriz me rrënjë të thella në folklorin shqiptar. Ai ishte nipi i Gjergj Mark Gurit dhe Kolë Mark Gurit- Laruat Kombëtarë, njeri në Shkodër dhe tjetri në Lezhë. Zëra të hershëm të radiofonisë shqiptare. Ndërkohë që gjyshja e tij, Zojë Mustafja ka qenë një nder vajtoresh më klasike të maleve Shqiptare. Ajo ka mahitur At' Shtjefen Gjeçovin dhe At' Benardin Palajt, të cilët i referohen në studimin e tyre në fushën e folklorit. Mhilli, ishte një talent i lindur me dhunti specialë, poetike, vokal të kristaltë, një zë sa kumbues aq të ëmbël që u bë e mbeti bashkëshoqëruesi më i mirë i perlave poetike, që i buronin nga zemra, duke i rritur e kthyer në hitet më të dashura për veshin e zemrat e miliona shqiptarëve. -Mhilli, u rrit së bashku me çiftelinë dhe në skenën e shtëpisë së Kulturës Breg Lumi, në të cilën ka kënduar që në moshën 8 vjeçare. Mhilli, mjeshtër autentik i majave i dha flokut burimor jehonë në gjithë hapësirën mbarë shqiptare, për mes valëve të "Radio Tiranës"; "Radio Tiranës për shqiptaret jashtë atdheut" e RTVSH.

Ai ka marre pjese në qindra, koncerte e manifestime folklorike në skenat brenda dhe jashtë atdheut, kudo që jetojnë shqiptaret, ndoshta si as kush tjetër në zonën ku kumbon çiftelia janë memorizua në arshivën e flokut hite kombëtare të pa vdekshme 20 këngë, qe nga kënga "Pret Stambolla Skënderbeun" e deri te kënga "Ka je nisë Turgut pasha". Repertori artistik i tij përfshinë mbi 250 këngë. Mhill Çuni nuk ishte thjeshtë një rapsod, por së pari një poet i talentuar dhe duke qenë i tillë është nder Kantautorët e pare dhe pa dyshim më të talentuarit e kohës së tij. Ai ka marrë pjesë në festivallet Folklorike Kombëtare të viteve 1978, 1983 e 1988. Në vitin 1982 kur ishte në Shtëpinë e Kulturës Breg Lumi, në bashkëpunim me muzikolo-

gun Robert Prendushin dhe Përgjegjës të Kulturës Gjergj Çuni zbuluan dhe vunë në skenë Vallen burimore "T' Lekve", e cila shkoj dhe mori çmim kombëtarë në Gjirokastër.

Në vitet 1981-1990, drejtues i jetës kulturore e artistike në Gruemirë, Malësi e Madhe. Në vitet 1999-2002, ideator dhe drejtues i spektaklit "Hitet Folklorike" në TV1 Channel, Shkodër. Themelues dhe drejtor artistik i veprimtarisë kulturore "Sofra e Dukagjinit".

Për këto vlera është nderuar me tituj nderi:

Në vitin 1983 dhe 1988, është fitues Laurat i festivaleve folklorike;

Në vitin 1996, fitues i çmimit "Rapsodi më i Mirë", në Takimin Kombëtar të Lahutarëve, në Lezhë. Në vitin 2017, 'Qytetar Nderi' i Komunës Rrethina, Shkodër.

Në vitin 2017, nderuar nga Shoqata Atdhetare "Dukagjini", me titullin "100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin"

Në vitin 2019, Çmimi "Krenaria e Sofrës së Dukagjinit".

Në muajin shkurt 2021, Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", me mbështetjen e Kryetares së Bashkisë Shkodër, zonjën Voltana Ademi, i ka propozuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë, për ta dekoruar me urdhrin "Mjeshtër i Madh".

\*\*\*

Uroj nga zemra, që Shoqata Atdhetare "Dukagjini", nen drejtimin e kryetarit të saj, z. Ndue Sanaj, të promovojë e realizojë shumë projekte të tilla, që ia ndritin faqen Dukagjinit dhe Dukagjinave që meritojnë kaq shumë.

*Presidenti i Republikës z. Ilir Meta, duke dorëzuar urdhrin "Mjeshtër i Madh", vajzës së Mhill Çun Gjonaj, Kristianës*

**Kadri Fikaj**, poet e publicist, Shkodër, më 21 janar 2022



- Në vitin 2004, gardën Major;
- Në vitin 2009, gradën Nënkolonel;
- Shtator 2016, gradën Kolonel.
- Me 26 nëntor 2021, gradën Gjeneral Brigade.

### Dekorime:

- Për punën e bërë ka marre dhe vlerësime gjatë gjithë kësaj karriere të shkëlqyer:
- "Medalja e Karrierës" mbi 10 vjet shërbimi në F. A, akorduar nga Komandanti i Forcës Tokësore, me 26 11. 2004;
- Medaljen e Misionit në Operacionin ALTHEA 2005 në BiH;
- Çmimin e Komandantit të akorduar nga Komandanti i Trupave Gjermane në Operacionin ALTHEA BiH, Prill 2005;
- Medaljen e Misionit në Operacionin ALTHEA 2006 në BiH;
- Çmimin e Komandantit, akorduar nga Komandanti i Trupave Gjermane në Operacionin ALTHEA BiH, Maj 2006;
- "Medalja e Karrierës" mbi 15 vjet shërbimi në F.A akorduar nga Komandanti i

- Forcës Bashkuar, me 21. 11. 2007;
- Medaljen "Për pjesëmarrje në shërbime Ndërkombëtare", akorduar nga Ministri i Mbrojtjes, me 30. 11. 2007;
- "Medalja e Karrierës" mbi 20 vjet shërbimi në F. A, akorduar nga Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, me 26. 11. 2012;
- Me rastin e 15 vjetorit të themelimit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", është vlerësuar me titullin e lartë "Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini".

**Gjuhë të huaj** të mbrojtura me Dëshmi: anglisht, gjermanisht.

\*\*\*

Gjeneral Petritin e njoha në vitin 1998, në detyrën e komandantit të kompanisë së tankeve dhe me gradën kapiten i I-r, në Brigadën e Tankeve, me vendvendosje në rajonin e Melgushës. Një djalë i gjallë, që respektohesh nga të gjithë koleget, eproret dhe vartësit. E pyeta:

- Nga jeni i nderuari Kapiten i I-r? Ai, me atë krenarinë prej nga ishte, mu përgjigje:

- Jam nga Dukagjini, fshati Gimaj, i krahinës së Shalës.

I them:

- Eh, atëherë paskemi se, pse të komunikojmë më shumë e përherë! Dhe unë jam nga Dukagjini, fshati Gjuraj, krahina e Pultit.

Kështu filloi njohja, filloj shikimi me një sy tjetër në shërbim të funksionit të tij dhe të timin në atë kohë. Dhe vërtete ishte për tu parë ndryshe!

Në të gjithë veprimtarinë e tij reflektonte kulturë qytetare dhe ushtarake, korrektësi shembullore, përkushtim ndaj detyrës, kërkues dhe respekt ndaj vartëseve, hapësira ku shtrihej kompania e tij ishte shembull për të gjithë të tjerët, guximtar dhe punëtorë i palodhur.

Bëra përpjekje të ndjek gjithë ecurinë e tij të mëtejshme, kur isha në detyrë dhe pasi dola në pension, që shpesh jemi

takuar e kemi shkëmbyer mendime për reformimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë se, ai ishte dhe është një oficer karriere i kompletuar.

Për punën e karrieren e tij mund të shkruhet shumë e shumë, por më duket jo e drejtë se, për Gjeneral Petrit Çuni më shumë se kushdo tjetër flete CV-ja e tij.

\*\*\*

Gjeneral Petrit Çuni, krenaria është fjalë e vogël për të përshkruar çfarë ndjejmë në përfundimin e këtij shkrim modest, për karrierën tënde të shkëlqyer! Jo vetëm ishim të bindur, kur kryesia e Shoqatës të dha titullin e lartë "Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini", por ajo bindje përforcohet gjithnjë e më shumë, dhe me gjithë forcën e shpirtit, në emër të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" të urojmë, me shprehjen dukagjinase: "Me faqe të bardhë gradën e Gjeneralit!"

**Ndue Sanaj**, janar 2022

# EDICIONI I 10-të: PERSONALITET E VITIT 2021

(Best-North-Buna 1-10-2021)

Me datën 20 janar 2022, dite e Enjte, në orën 18. 00, në Teatrin "Migjeni", u zhvillua ceremonia e Natës Finale e personaliteteve të vitit 2021 për Shkodrën.

Një organizim i shkëlqyer nga Presidenti i spektakleve "Buna 1", nga zoti Arben Mazi. Kjo veprimtari prezantuese e votuese ka filluar me datën 10 dhjetor 2021 deri me datën 10 janar 2022, për personalitete në tetë fusha të ndryshme: mësuesi më i mirë; humoristi më i mirë; këngëtari më i mirë; sportisti më i mirë; piktori më i mirë; politikani më i mirë; shkrimtari më i mirë dhe trajneri më i mirë.

Pas 30 ditë votimi, më të mirët e vitit 2021, në këto fusha të veprimtarisë në shoqërinë tonë, dolën:

Mësuesi më i mirë doli, mësuesi Ferdo Borshi; humoristi më i mirë, doli humoristi Aleksandër Prenga; këngëtari më i mirë, doli këngëtarja Jozefina Simoni; sportisti më i mirë, doli futbollisti Mevlan Adili; piktori më i mirë, doli piktorja Denisa Ibrahim; politikani më i mirë, doli politikania Edona Bilali (deputete e qarkut Shkodër për PS-ne dhe Ministre shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes); shkrimtari më i mirë, doli shkrimtari Prele Milani dhe trajneri më i mirë, doli trajneri Elion Puka.

Pas shpalljes dhe dhënies së çmimeve të personaliteteve të vitit 2021, Buna1, dha dhe disa tituj "MIRENJOHJE", për personalitete të veçanta, si: Për skulptorin e talentuar Ferid Kola; për Arbër Xhaferri; Angjelin Grizhaj, aktorin e Mjeshtër të Madh, Agron Dizdarin dhe këngëtarin e talentuar Mukades Çanga.

Me ane të këtij shkrimi publicistik, dua të pershndes e komplimentoj mikun tem Arben Mazi, për profesionalizmin e transparencën që mbi një dekadë, me Agjencinë "Buna 1" ka mbërritur me evidentua e vlerësua, me merite figura të shquara, të cilët kontribuojnë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, politikës, shkencës, kulturës, arsimit, sportit e të tjera në Veriun e Shqipërisë dhe më gjere.

## Kush është Prele Milani?

**Prele Milani, është shkrimtari i vitit, për vitin 2021**

Prele Milani... Çka mund të shkruash për Prele Milanin e palodhur. Ai ka shkruar e botua 21 libra mjaft cilësor, 7 vëllime poetike, 2 novela, 11 monografi e biografi, me mbi 2000 faqe, si dhe mbi 500 artikuj publicistik të botuar në shtypin periodik të kohës. Unë, në vijimësi e pyes veten e miqtë e mijë, si ja del Prele të studioje, të shkruaj e të botoje, duke qene punonjës i mirë (oficer) i Policisë së Shtetit, familjar i mirë edhe pse me mjaft ngarkese e probleme familjare e shëndetësore, me zhvillua gjithë këtë aktivitet si shkrimtar, historian, e publicist?! Përgjigja është, veç

Prela e një Zot e dine!! Por edhe votat e fituara dhe shpallja shkrimtari i vitit, është përgjigja më e mirë, është përgjigje mjaft domethënëse.

\*\*\*

Prela ka lindur me 28 prill 1963, ne fshatin Pepsuj, në krahinën e Shoshit, Shkodër dhe banon ne lagjen Kiras, Shkodër.

Shkollën 8 vjeçare e ka kryer ne vendlindje, shkollën e Mesme Përgjithshme "29 Nëntori", Shkodër, shkollën e larte, ne U. SH "Luigj Gurakuqi. Fakulteti "Histori- Gjeografi", është specializuar për Histori moderne dhe ka kryer studime në Akademia e Policisë, në Tiranë.

Përvoja në pune: Mësuese historie në shkollën 8-vjeçare Ndrea Shosh; Mësues në shkollën e Mesme të Përgjithshme Shosh (krijues dhe drejtues i rrethit metodik të historisë së zonës për 10 vite), Mësues historie në shkollën e fshatit Shtoj i vjetër, Shkodër.

Ne vitin 1998 e deri tani është transferuar në Drejtorinë e Policisë Shkodër dhe ka kryer disa funksione te ndryshme: Shef Personel Organizimi i Drejtorisë së

Policisë Shkodër; Komandat Trafiku në Komisariatin e Policisë Pukë; Komandat i Policisë se Rendit në Komisariatin e policisë Malësi e Madhe; -Komandat i Policisë Rendi Komisariatin e Policë Shkodër; Komandat i shërbimeve të Kufirit Shkodër; Specialist Drejtimi në Komisariatin e Policisë Mat; OPGJ në Komisariatin e Policisë Lezhë; OPGJ i në Komisariatin e Policisë Shkodër; Shef Stacioni Policore Fushë Arrëz; Shef i Trajnimeve të Drejtorisë Policisë Shkodër dhe vijon në detyrën e komandantit e policisë, me qendër në fshatin Theth.

Prele ka një eksperiencë letrare – publicistike: Anëtarë i ish Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë; Anëtarë i Unionit të Gazetarëve Profesionist të Shqipërisë; Anëtarë i Shoqatës së Shkrimtarëve Shkodër, anëtar i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" qe ne themelimin e saj dhe tani është N/Kryetari i saj dhe autor i mbi 500 reportazheve, shkrimeve publicistike, historike dhe humorit stikë në gazetën "Shkodra", "Shqipëria Etnike", "Dukagjini", "Koha jonë", "Shekulli", "Panorama", "Gazeta shqiptare", "Sot" "Standard", "Telegraf", "Ndryshe", "Humor e Satirë",

"Kunji", "Fjala" e të tjera

## Krimtaria e tij deri tani është paraqite në këto botime:

- Qaj e qesh për shtetin- *satira*;
- Bibla në vargje - *poezi*;
- Dukagjini ynë, vëllimi I - *antologji historike*;
- Bota Sillet rreth grave - *satira*;
- Dukagjini ynë II (Artistë të shquar) *studime biografike*; Dukagjini ynë III (Sportist të shquar) - *studime biografike*; Lufta e Çuditshme" - *monografi historike*;
- Balc Ndou - "Prijsi i Djelmisë së Shoshit" - *monografi*;
- Zoti Rrush - *satira*;
- Shoshi, *monografi historiko-gjeografike*;
- Atentati që tronditi dy shtete, *monografi historike*;
- Profesor Kolë Prela, deputeti historik i vitit 1946 - *monografi*; Dodë Tahiri erdhi dhe iku si meteor, *monografi*;
- Burrat vdiqën rrofshin gratë- *Satira*;
- Fanolistët martir të Pukës dhe Dukagjinit, *Studime historike*; Zoja e Berishës, *studime etnografike*;
- Dukagjini ynë IV, *klerikë dhe martir të shquar*;
- Shqiponjat e Ballkaniadës 1946, *monografi*;
- Babagyshat e Kombëtares, *almanak poetik*;
- Marash Tuci, ndorja shqiptare, *novelë*;
- Engjëjt mashtrues, *satira*
- Libra në proces;
- Pirro i Epirit, *poezi*;
- Mbretërit e Ilirisë;
- "Dukagjini Ynë" - vëllimi V-mendje të ndritura
- "Njomëza" - *novelë*

## Për punën e tij të mirë, është vlerësua:

"Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini", për veprimtari intelektuale e kulturore;

"Qytetare nderi" i Komunës Rrethina;

"Mirënjohja Martin Camaj"

"Medaljonin 100 vjet Arsim e kulturë në Dukagjin".

\*\*\*

Në mbyllje, dëshiroj ti uroj mikut tim Prele Milani, shëndet e energji të reja në punën e tij të palodhur në hulumtimin, pasqyrimin e përjetësimin nëpërmjet veprave të tij, të fakteve e personave historike, traditave e vlerave kulturoro-historike të trevës shumë interesante, të Dukagjinit e jo vetëm!

Gjergj Leqejza, Shkodër,  
me 22 janar 2022



# SOFRA E SHKODRËS BUJARE

Shoqëria Kulturore “Jehona e Shkodrës”, shtron sofren tradicionale shkodrane

Dhjetori i kishte veshur qytetit petkun shumëngjyrësh të festave të fundvitit, i rrethuar nga një atmosferë mbresëlënëse, duke shërbyer kështu edhe si një dekor gjigand piktoresk, për t'i dhënë kësaj Sofre emrin e mikpritjes së Rozafës së lashtë, që shkodranët e të gjithë brezave meritojnë ta kenë.

Kështu pra, në këtë atmosferë të gëzueshme e entuziaste u shtrua “Sofra Shkodrane” edhe këtë vit. Kjo ngjarje rastisi të organizohej dhe të bëhej edhe më interesante si pjesë e munguar për shkak të pandemisë së tejzgjatur, sepse Shoqëria Kulturore “Jehona e Shkodrës” në bashkëpunim me Televizionin Star Plus, ishin kujdesur që ta risillnin atë në jetën artistike të qytetit me të gjithë madhësinë e spektaklit tradicional të fundvitit të pagëzuar “Sofra Shkodrane”, duke bërë pjesëtare të saj pjesëmarrjen e këngëtarëve dhe humoristëve më të shquar shkodranë, ku natyrisht do të përmendim “Mjeshtrin e Madh” Bujar Qamili, “Mjeshtrën e Madhe” Mukades Çanga dhe këngëtarët aq të dashur për publikun shkodran: Eduart Jubani, Adnan Bala, Agim Molla, Ben Goçaj, Laorjan Ejlli, si dhe Gëzim e Egzona Salaj nga Ulqini, shoqëruar nga orkestra me instrumentistët e mrekullueshëm Arben Dema, Elvin Unaza dhe Miri Zurali drejtues muzike. Teknik fonie Sadetin Bajraktari, Inspektor skene Sabah Baxha, regjisor Zef Deda, producent Xhelal Halili.

Këtë spektakël tashmë tradicional e bënë më të këndshëm dhe më popullor humoristët e shquar shkodranë: “Mjeshtrat e Mëdhenj” Zef Deda, Besnik Çinari, Drande Xhai, si dhe Grupi “Gaz e maraz” Gac Kodrina e Qazim Çela. Një vlerë në këtë sofër shkodrane ishte edhe performanca e bejtaxhinjve, që me improvizimet e tyre sollën gaz, humor, shpoti e satirë të hollë ashtu si në jetën e përditshme të qytetit, ku vetë qytetarët shkodranë nuk ia përtojnë të venë në lojë vese të ndryshme, personazhe sociale e politike, që “ia kanë ba vendin”.

Bejtat shkodrane dhe kënga popullore janë gjithmonë të pranishme në ambientet tona, si një ushqim shpirtëror dhe si një pjesë e pandashme e këtij qyteti. Një larmi pra të veçantë kësaj Sofre i dha edhe Grupi i Bejtave Shkodrane me bejtaxhinjtë e saj, tashmë të afirmuar si artistë popullorë: Bujar Zurali, Dilaver Cufi, Isuf Çoku, Dila Mataj dhe Agron Zaganjori.

Pavarësisht nga vështirësitë që qyteti i Shkodrës ka përjetuar në këtë kohë pandemie ashtu si gjithë Shqipëria, e pse jo, si e gjithë bota, ditë më të bukura dhe më optimiste kanë ardhur në vazhdim, pasi ky qytet në raste festash, sofrat gjithmonë i ka shtruar me bujarinë dhe mikpritjen që e ka karakterizuar. Kështu që mendoj se shtrimi i kësaj Sofre bujare këtë radhë, e cila këtë vit festoi 21-vjetorin e saj si një spektakël shumë popullor, ka një veçori të lavdërueshme, sepse u shtrua në një lokal me një emër shumë domethënës “PAN-

ORAMA” me pronar z.Bilal Mehaj. Domethënës, sepse ky ambient tregoi se është thellësisht jo vetëm pronë e qytetit të Shkodrës, por edhe një evokim i dashurisë së madhe që kanë të gjithë shqiptarët e emigruar, e në mënyrë të veçantë Diaspora jonë që na bën aq krenar.

Ashtu siç e kishin menduar organizatorët, ku natyrisht meritat i takojnë ideatorit prej 21 vitesh të këtij evenimenti z.Xhelal Halili, Sofra Shkodrane i mirëpriti miqtë e saj ashtu siç i ka hije, me tingujt e këngëve të pavdekshme shko-

shkodrane, freski i jepte audiencës mosha e re e spektatorëve, djem e vajza shkodrane që shpesh pa të drejtë “akuzohen” se rendin pas muzikës moderne dhe harrojnë se qyteti i tyre ka këngë shumë të bukura.

Kjo festë e vërtetë, kjo mbrëmje magjike, ngjasonte me dasmat tradicionale shkodrane që bëheshin dikur në oborre, ku ashikë e dashamirë të këngës rrinin me orë të tëra për të shijuar magjinë e Ahengut shkodran dhe pastërtinë e humorit që nuk mungonte kurrë. I shkojnë këtij qyteti



drane. Në atmosferën që krijoi me zërin e tij të mrekullueshëm “Mjeshtri i Madh” Bujar Qamili, ku skenë bëri gjithë sallën dhe “partnerë” të gjithë të pranishmit, që në këmbë duartroktonin, vallëzonin dhe shoqëronin me zërin e tyre, këngët e tij të mrekullueshme, u ngritën dollitë, pjesëmarrësit uruan njëri-tjetrin për një vit të mbarë, për begati e lumturi në familjet e gjithsecilit, duke sfiduar kështu edhe hallet që asnjëherë nuk mungojnë. “Jehona e Shkodrës” me producent z.Xhelal Halili vlerësoi kontributin e këngëtarit Bujar Qamili të dhënë ndër vite me një “Mirënjohje”. Salla u elektrizua, sepse ishte mbushur si rrallë herë me spektatorë artëdashës, siç mbushet një bahçe me lule të bukura në pranverë. E veçantë dhe pozitive ishte se përveç dashamirësve të moshuar të këngëve popullore qytetare

këto lloj festash, këto manifestime sa të bukura aq dhe kulturore e shpirtërore, siç i ka hije edhe “Sofrës Shkodrane” me ritme e hove rinore.

“Sofra Shkodrane” tregoi se di ta ruajë traditën e bukur të këtij qyteti të shquar të artit dhe të kulturës, ku zërat e papërsëritshëm të këngëtarëve të mrekullueshëm, jehuan në çdo kënd të sallës, përqaftuan dhe përkëdhelën të gjithë tavolinat e shtruara në këtë mbrëmje dhe e kthyen këtë sofër në një dasëm të vërtetë shkodrane. Gjithsecili këndonte, gjithsecili cakronte gotën, duke u ndjerë krenar dhe që në prezantimin e parë u përçollën emocione që spektatorët e pranishëm kishin kohë pa i shijuar.

Për ta mbajtur të gjallë këtë traditë, për të mbajtur në formë interpretuesit e vjetër dhe për të sjellë zëra të rinj, Agjensia e

spektakleve “Jehona e Shkodrës” hodhi hapat e parë për të krijuar edhe ajo vetë një traditë, që tradita e vjetër të mbetet e gjallë, autentike, por edhe e freskuar me interpretues të rinj që janë pikërisht ata sot përfaqësues të këtij burimi të pashtershëm.

Sofrat bujare nuk shtrohen kurrë vetëm me njerëzit e shtëpisë. Ata pikërisht pse janë bujare dhe mikëpritëse, në vendet e nderit kanë miqtë. E këta nuk ishin pak. Kishin udhëtuar nga larg. Miq dhe artistë, kishin ardhur nga Kosova, nga Labëria, nga Mali i Zi, nga Maqedonia, Europa e deri nga Amerika e largët, për të çuar një dolli në sofren shkodrane, për t'i treguar Shkodër Loces se gjithmonë e kanë dashur dhe respektuar këtë qytet të mrekullueshëm, këtë qytetari që gjithmonë i ka dhënë Shqipërisë atë që ky vend i quajtur Atdhe ka pasë nevojë: Kulturën, arsimin, artin, shkencën, sportin dhe gjithçka që i ka paraprirë zhvillimit.

Mbrëmja kaloi me një atmosferë jashtëzakonisht të gëzueshme. Ritmet e muzikës, zërat e mrekullueshëm të këngëtarëve, numrat e përzgjedhur të humoristëve shkodranë, si dhe surprizat që sollën, krijuan një atmosferë të tillë, ku akrepat e orës nuk kishin asnjë vlerë në lëvizjen e tyre.

Ky organizim, të rikthehem edhe një herë, meritat kryesore i ka nga Shoqëria Kulturore “Jehona e Shkodrës”, me producent z.Xhelal Halili, por gjithmonë në sofra edhe disa nga miqtë kanë merita të veçanta, aq më shumë në sofrën shkodrane. Për këtë aktivitet kaq emocionues, por edhe të rëndësishëm të qytetit të Shkodrës, do të prononcoheshin edhe përfaqësues të shquar të jetës kulturore e artistike. Poeti i shquar Agim Doçi “Mjeshtri i Madh” ishte një ndër miqtë më të nderuar, jo vetëm për lidhjet e tij me qytetin e Shkodrës, por në mënyrë të veçantë me lidhjet e tij me artistët e qytetit të Shkodrës, i cili me shumë përmallim u shpreh: “Sofra Shkodrane po bëhet një traditë e bukur. Edhe sivjet u kënaqem dhe u përmalluam me këngën shkodrane që nuk vdes kurrë. Sa mirë do të ishte që në rreshtat e parë të sallës të shihnim ata që i dhanë jetë këngës shkodrane dhe e ngritën aq lart. Mos i harroni ata, ju që organizoni koncerte kaq të bukura. Prania e tyre ia shton bukurinë këtyre veprimtarive. Shkodra gjithmonë ka patur vlera të tilla që e them me bindje se nuk mund t'i ketë çdo qytet”. Ngrohtësi kësaj Sofre tradicionale i solli edhe moderatoresja e talentuar Ketlin Pjalmi.

“Sofra Shkodrane” këtë natë nuk njohu limite kohe, por si një sofër e madhe bujare bashkoi rreth saj deri në orët e para të mëngjesit, të zotët e shtëpisë dhe miqtë e ardhur nga gjithë trevat shqiptare dhe Diaspora, duke treguar kështu se është sofra e një shtëpie që festat gjithmonë i feston me vëllezër, miq dhe dashamirë.



# Mjeshtri i Madh Ali Mulaj

Të flasësh për Ali Mulaj, (Mjeshtër i Madh), duhen shumë fjalë... për djepin e kulturës së Tropojës Ali Mulaj pata fatin t'a njoh para 5-vitesh shprehet kryetari i këtij ansambli zoti Ikli Punavija, nëpërmjet Shoqërisë Kulturore "Arthemëria" Gjakovë drejtuar nga Egzon Ademaj dhe Ilir Sylmetaj. Kisha dëgjuar për Aliun dhe kontribudi i tij ndër vite jo vetëm në fushën e stomatologjisë por dhe si artist kontribudi i tij ishte aq i çmuar sa kushdo që e njihnte Ali Mulaj, nëpërmjet tingujve të bilbilit që kur interpretonte Aliu dhe zogjtë e malit e ndalonin këngën.... Ali Mulaj ishte njeri human, korrekt dhe shumë shpirtëror dhe artist i madh i kombit shqiptar si artist dhe instrumentist dhe drejtues i shumë evenimenteve artistike-kulturore në Tropojë dhe mbarë trojet shqiptare duke filluar që nga Kosova etj. Pata fatin që me Aliun jo vetëm të njihem por dhe të bashkëpunoj me të në ide, mendime të ndryshme si dhe në organizime folklorike mbrenda dhe jashtë vendit. Në vitin 2018-2019 pata fatin që Aliun t'a kem kryetar jurie në dy organizime folklorike që u zhvilluan në qytetin e Klosit të Shqipërisë, "Fest - Folk Klosi 2018", "Fest-Folk Klosi 2019", ku në cilësinë e drejtorit të këtij festivali me shumë kënaqësi dhe krenari vendosa që kryetar jurie të jetë i ndjeri Ali Mulaj. Jo vetëm në organizimin e festivalëve zhvilluar në qytetin e Klosit por dhe në takime, evenimente të ndryshme, Ali Mulaj gjithmonë ishte i pranishëm në Klos ku Grupi Folklorik "Petralba" Klos organizonte veprimtari të ndryshme folklorike, takime etj. Ndarja nga jeta e artistit të kombit shqiptar Ali Mulaj na la një boshllëk të madh që me dhimbje të madhe do t'a kujtojmë gjithmonë brez pas brezi jetën dhe veprimtarinë e tij ndër vite në jetën artistike që Aliu la emër dhe shembull të mirë jo vetëm si artist dhe kontribues i veçantë i ruajtjes dhe trashigimisë kulturore ndër breza. I madh dhe i vogël derdhën lot dhe përjetuan dhimbje për ndarjen nga jeta të artistit të kombit shqiptar Ali Mulaj, sepse njerëz dhe artist si Aliu do t'i mungojnë gjithmonë kombit shqiptar sepse zemërgjersia dhe vullneti i tij ishte aq i madh dhe i palodhur edhe pse vitet

kalonin si valët e detit, por Aliu deri në momentin që u nda nga jeta nuk ju nda artit dhe folklorit në pjesmarrjen e shumë evenimenteve artistike-kulturore që zhvilloheshin mbrenda dhe jashtë vendit ku ajo e fundit ishte pjesëmarrja e tij në Dajt, "Dita e Plisit", organizuar nga Agron Isa

Sado vitet kanë me kaluar Ali Mulaj gjithmonë do të mbetet i paharruar... Kryetari i Grupi Folklorik "Petralba" Klos zoti Ikli Punavija vizitoj familjen Mulaj në Tiranë dhe premtot që miqësia me familjen Mulaj do të vazhdojë derisa të na ndalet fryma si baca Ali pasi ne e kemi për nder dhe

në banesën e fundit merrnin pjesë shumë të pranishëm si kryetari i Bashkisë Tropojë, Shoqëri të ndryshme folklorike nga mbarë trojet shqiptare si dhe nga shumë vende të Republikës së Kosovës, njerëz të artit dhe folklorit shqiptar. Arkimede Lushaj i quajtur ndryshe "Stresi", nipi i Aliut ban krenar familjen Mulaj por dhe ne si miq të ndjerit Ali, pasi jo vetëm njeri dhe personazh i njohur por edhe si njeri vërtet kishte një virtyt të lartë që emrin e gjyshit tij Ali Mulaj sa vjen e lartëson çdo ditë pasi ban krenar familjen dhe ne si miq të gjyshit të tij që vërtet me plot gojën themi qofsh faqe bardhë gjithmonë nipi i Ali Mulës dhe zoti ju bekoftë në çdo hap jetës tuaj sëbashku me familjen tuaj të mrekullueshëm me shumë krenari Arkimede Sali Lushaj nderon vetën, familjen por dhe figurën e paharruar Ali Mulaj. Fëmijët e të ndjerit Ali Mulaj, djemtë dhe vajzat Guximi, Shpresa, Elfa, dhe Naseri ndjehen krenar për babain e tyre për vlerat e tij dhe vlerësimet që i zhvilluan dhe në ceremonin mortore ku u përcjell për në banesën e fundit mes dhimbjesh dhe lotësh në vendlindjen e tij Tropojë ku prehet i qetë Ali Mulaj që amaneti i fundit i Aliut u mbajt deri në fund nga familjarët e tij. Ali Mulaj ka shumë nipa dhe mbesa një nga këto dua të theksoj Dardan Mulaj aq ardashës dhe shumë i pasionuar pas artit dhe folklorit ku ndjehet krenar Dardan dhe gjithë nipat e mbesat e Aliut për gjyshin e tyre që do t'a kujtojnë me mall dhe krenari gjithmonë ndër breza. Bashkëshortja e Aliut jetoj plot 60-vite me të dhe humbjen e bashkëshortit saj e quan dhimbje pasi Aliu ishte njeri me vlera dhe shumë familjarë i rregullt dhe korrekt si në familje, shoqëri, në fushën e mjeksisë dhe të kulturës.



Prof. Muhamet D. Rogova, Jakup Krasniqi, Ali Mulaj, IKLI Punavija e Nuhi Krasniqi



Ferit Hoxha, Ali Mulaj e Ikli Punavija

Gjedia, ku merrnin pjesë shumë të pranishëm si nga Republika e Shqipërisë, Kosovës dhe mbarë trojeve shqiptare. Ali Mulaj do të na mungoj gjithmonë me këshillat e tij që do të na vlejnjë aq shumë brez pas brezi pasi janë këshilla që do t'a ndjekim rrugën e tij me shumë dinjitet dhe krenari të lartë! Ali Mulaj u nda nga jeta Emri i tij do jetoj gjithmonë ndër breza,

krenari të ruajmë dhe të trashëgojmë figurën e lartë të kulturës shqiptare Ali Mulaj nga Tropoja, ku aty në Bjeshkët e Tropojës po vajton qyqja kur nuk dëgjon tingujt e bukur të mahnitshme të bilbilit që Aliu shoqëroj me dekada me rradhë si rapsoden e paharruar Fatime Sokoli, e shumë të tjerë rapsod, këngëtarë, valltar të njohur të Tropojës. Në homazhet e përcjelljes për

Në emër të Grupit Folklorik "Petralba" Klos dhe Ansambli Folklorik Burimor Mbarëkombëtar i shprehim ngushëllimet më të sinqerta familjes Mulaj për ndarjen nga jeta të artistit të kombit shqiptar Ali Mulaj i cili do të na mungoj gjithmonë brez pas brezi. Ansambli Folklorik Burimor Mbarëkombëtar.

**Ikli Punavija, Kryetari**

## Ndahet nga jeta Mjeku i Shllakut, Sokol Preçi

Me trishtim të thellë mesova ndarjen nga jeta në një spital në NY në Sh.B.A Dr. Sokol Preçi. Sokoli vuan nga një sëmundje e rëndë dhe e pashërueshme prej kohësh. Fale ndihmes së shokut të tij të fakultetit Dr. Ndoc Deda nga Xhani, ai mundi të nenshtrohej një terapi të specializuar. Edhe pse vete ishte mjek, nuk mundi ta perballojë. Ndarja e tij nga jeta me trishtoi se Sokoli ishte njeri i guximshëm por kjo ishte jeta. Sokoli lindi në fshatin Vukaj, Shllak ku mori arsimin 8 vjeçar në Barcolle e te mesmen në Shkollën e Mesme Bujqësore Shllak. Si konvik-

tor që ishim pata fatin ta njoh nga afer ku dallohej si nxenes shembullor në klasën e tij. Sokoli vinte nga një familje e nderuar që kishin kundërshtuar regjimin komunist, por fale aftësive të tij me shumë mundësi sakrificë mbaron Universitetin e Tiranës në degën mjeksi e përgjithshme. Sokoli sapo mbaroi fakultetin mjekësor punoi pa u lodhur në Spitalin e Shllakut ku sherbeu me vetmohim e sakrificë për banoret e tij. Dallohej për perkushtimin që kishte pa marrë parasysh vështiresitë. Sokoli pati një karriere të shkëlqyer në mjeksi ku punoi si mjek pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme. Pas specializimit për Nerolog punoi shumë vite në Spitalin Nënë Tereza në Tiranë me profesorin e nderuar Dr. Vuksan Kola. Ndarja para kohe me pikelloi pa mase ku familja

humbi njeriun e tyre të dashur e Shllaku mjekun e birin e tij të nderuar. I shpreh ngushëllime familjes dhe të afermeve, shokeve e miqeve të tij kudo që ndodhen për këtë humbje të parakoshme. Pushofsh në lumninë e qiellit Dr. Sokol Preçi. Dua të falenderoj të gjithë shqiptarët nga Dukagjini e me gjere në Amerikë që ben të mundur sjelljen e trupit të pa jete në Shqipëri për tu varrosur pranë familjave në Shkoder, si; Dr. Ndoc Deda, Ndoc Ndre Sukaj, Mond Pjeter Gjoni, Astrit Gjoni-pali, Tonin Marash Lisna, Ndrek Tonaj, Kol Ded Ndrejaj, Kujtim Finiçi, Erland Luigi Lisi, Lin Kumblla, Alban Kaçaj, Eduart Nikollaj, Paulin Lufaj, Sokol Kodra, Bardhok Zhuri, Fation Martin Shytani, Eduart Mark Bludaj etj.



Zef Nika, Ndoc Prendushi, Nikolin Gjoni, Hil Molla, Pjeter Zymeri, Ndoc Nika, Mikel Sokoli, Mond Pjeter Gjoni, Pjeter Prendi, Ndoc Thanza, Hil Kodra, Dod Lunaj, Vat Marashi e Petrit Dedndrejaj.

# Ditët e mia të errta me alkoolin



Lekë Imeraj,  
shkrimtar, përkthyes, publicist

Isha 30 vjeçe. Bëja një jetë të mbyllur, një jetë të cilën nuk e dëshiroja aspak. Nga jashtë gjithçka dukej mrekulli. Pas fasadës, fjalën e kishte alkooli. Ai vendoste për mendimet e mia, për veprimtarinë time ditore. Mori përsipër netët dhe planet e jetës. Sa më shumë që shtoheshin gotat e verës, aq më shumë deformathe personaliteti i im. Aq më shumë largohesha unë nga puna, nga njerëzit dhe jeta. Aq më shumë zhytesha në problem, me të gjithë dhe me gjithçka.

Endrrat e mia plasën, si fluska sapuni. Gjithçka që kishte vlerë për mua, u shndërrua në nul, në asgjë. Dhe, mospërfillje. Një mospërfillje e padurueshme, ndaj vetes time, për ato që bëja. Nuk më interesonte as lindja dhe, as perendimi i diellit. Ditët e mia ishin të gjitha njëjloj, të errta.

Ndjenja e nevojës për verën, më dehte, njëjloj sikur të kisha pirë disa gota. Më ngjallte panik dhe më kalonte në gjendje toksike.

Lufta me vetveten bëhe gjithnjë e më e ashpër. Kishte momente që, zëri im i brëndshëm bërtiste fort: "Mjaft tani! Hiq dorë nga ai send i shejtani! Ti po vdes!"

Mirë por, si? Si mund të hiqja dorë nga ai që më kishte pushtuar çdo qelizë të trupit dhe trurit? Aq sa më dukej sikur, gota e verës, ishte sinonim i jetës time. Nëse derdhej gota e verës, aty mbaronte edhe jeta e ime.

Në shoqërinë dhe rrethin tim, të gjithë pinin alkool. Ata pinin dhe, punonin, jetonin. Alkooli për ata ishte luks, kualitet i jetës. Për mua ishte një pllakë verri që, m'a kishte mbuluar jetën. Nëse do të ndahesha nga ai send i shejtani, do të më duhej të ngrihesha. Të punoja dhe të rendja njëjloj me të tjerët. Jo, nuk mundesha. Kisha humbur aq shumë sa, çdo riparim, shpirtërorë dhe fizik, më dukej i pamundur.

Dhe kush? Unë.

Unë që, asgjë nuk më kishte munguar, në jetën time. I kisha të gjitha mundësitë për të ndertuar një jetë të lumtur. Një femijeri të artë, me prindër të mrekullueshëm, miqësi të vertetë, një formim profesional, të përzgjedhur vetë. Një bashkëshort të përsosur, një jetë bashkëshortore ideale.

Dhe çfarë bëja unë!?

Kalova në vartësi të alkoolit dhe rrenova gjithçka. Gjithë jetën time e hodha në erë, si një banesë shumkatshe, me një shpërthim dinamiti.

Nuk e di sa herë kam përfunduar në spital, me uregjencën. Më mbanin dytri dit dhe, përsëri, më linin të lirë. Më pushtonte ndjenja e turpit kur, më duhej të tregoja, për aventurat e mia alkoholike. Për të ngushëlluar disi veten, më duhej të gënjeja. Dhe gënjeja, paturpësisht.

"Unë nuk jam alkoholiste. Më ka ndodhur një fatkeqësi dhe... prandaj u deha", u thoja unë vazhdimisht mjekëve. Vazhdimisht më duhej të sajaja "fatkeqësi", gënjeshtër. Nga turpi, mundohesha të mbuloja kokën, nuk guxoja të shikoja asnjërin në sy.

Shkëputa çdo kontakt me njerëzit. Me të gjithë, edhe me nënën time. Edhe në telefon nuk i përgjigjesha më. Meqënsë, nuk kisha asnjë mundësi tjetër për të siguruar alkoolin, u bëra hajdute. Në supermarket, fillova të vidhja shishe alkooli dhe ushqime. E tmerrshme! Kurrë nuk e kisha menduar një gjë të tillë. Por, jo vetëm kaq.

Dikur, e vetmja gjë që më mbeti, për të siguruar alkoolin, ishte trupi im. Trupi im, aq i bukur, që m'a kishin zili femrat dhe e lakmonin çmendurisht meshkujt, do të përfundonte si mallë tregu, tek meshkujt e rrugës. Shkoja në disko dhe, i tërhiqja burra në shtëpi. Qoftë dhe për një natë. U vidhja para nga portofoli i tyre.

Në një rast, njëri prej tyre më kapi mat. Të nesërmen, para se të largohesha nga unë, e hapi portofolin dhe, gjithë inat më tha: "Hej, ti prostitutë muti, më ke vjedhur parat. Plot 200 euro. Hajde, më jep shpejt parat ose njoftova policinë". Ia dhash parat. Megjithatë, e falënderova që u tregua aq human me mua. Ai mund të njoftonte policinë dhe... nuk dihej se si mund të shkonte puna.

Në momente të shkurtëra kthjellimi, mendoja: Si u katandisa unë kështë!? Nga, dhe, si më ndodhi kjo!? Nuk merrja përgjigje. Nga kush mund të merrja përgjigje!?

Jo vetëm atëherë por, edhe sot nuk jam në gjendje t'a spjegoj shkakun e ditëve të mia të errta me alkoolin. Gota e kristalë e verës, e mbushur me verën e shijshme, të cilën e pija në tavolinë me prindër dhe, më vonë me bashkëshortin, më pëlqente, më shijonte, gjithnjë e më shumë. Aq sa dikur, m'u bë zakon. Nuk përcillja dot asnjë kafshatë pa gotën e verës përpara. Dikur, gotat shtoheshin. Nga një, në dy, tri dhe... Zakoni përfundoi, me sukses. Ky zakon, më doli nga kontrolli dhe, më kaloi në vartësi të alkoolit. E gjithë kjo ndodhi shumë avash. Aq avash sa, ishte e pamundur, t'a vija re. Gjithçka shkoi aq larg sa unë, pa kuptuar asgjë, isha shndërruar në një hije të vetes time.

Ishte një ditë dhjetori, shumë e ftohtë. Jashtë termometri shenonte minus pesëmbëdhjetë gradë. Dritat, për arsye se nuk i paguaja dot, m'i kishin prerë me kohë. Përdorje vetëm qirinjtë të cilët, jo vetëm më ndriçonin por, për fajin tim, më digjnin edhe shumë gjëra në shtëpi. I hapa sytë. Po ndieja një pështjellim në stomak dhe, dhembje koke. Në krevat, pranë meje, gërrihiste një burrë lakuriq. Edhe sot nuk ia di as emrin, as moshën, as nacoinalitetin. Ishte nëri nga ata të rradhës.

U ngrita në këmbë. Nuk mbahesha

dot. Duke u mbajtur pas murecve, arrita në banjë. Pa dashur, i hodha një shikim pasqyrës. Pasqyra më reflektoi një përbindësh. As femër, as mashkull. Unë isha shndërruar në një përbindësh i vertetë. Fytyra dhe gjoksi im ishin plot me hematome, nga kafshimet dhe thithjet e njerit të panjohur.

Joooo, joooo, jo, bërtita me sa fuqi që kisha. Ndërkohë, dëgjova zerin tim të brëndshëm që më tha: Heej, ti je çmendur. Je verbuar. Hapi sytë! Kjo nuk ishte gjë e re por, e dëgjova më fuqishëm se kurrë. Nuk ishte një ndriçim i trurit tim por, një paralajmërim serioz, për daljen nga errësira ku isha zhytur.

Ky mëngjes ishte rezultati i shumë ditëve të gabuara. Rrufeshëm, më shkrepin një mendim në kokë. Unë kam vetëm dy mundësi: Vetvrasjen ose, braktisjen e alkoolit. Për vetvrasje nuk isha aspak e gatshme. Nëse do të vdisja, nuk do të



bëhesha aspak pishman por, vetvrasje nuk bëja dot. Unë duhet të heq dorë dhe, menjherë nga alkooli. Sot, jo nesër. Dhe pikë. Nga ky moment, vëndosa të shfaqem para njerëzve, ashtu siç ish, kockë dhe lëkurë. E çakërdisur, me pamjen e një të çmendure. Fare pa turp. Le të thonin të tjerët çfarë të donin. Ata që donin të më shanin, le të më shanin. Atyre që do t'u vinte keq, le t'u vinte keq.

Psikologjia amerikane Brene Brown, turpin e përshkruan si një epidemi të kulturës tonë. Turpi, nuk është vetëm turp. Ai është shkak i disa ndjenjave dhe sëmundjeve tek njeriu si, vartësia, deprëioni, shqetësime të ngrënit, brënga, dhuna, frika e fortë. Turpi të shkakton ndjenjën se, nuk je i plotë dhe, nuk i takon askujt. Njeriu humb vetëbesimin dhe, vullnetarisht, shkon drejt vetëngujimit. Gjithkush nga ne i njeh sociopatët dhe, të gjithë mundohen t'u shmangen atyre. Edhe ata vetë, mundohen t'a fshehin gjendjen e tyre, si të tillë.

Të dyja palët gabojnë. Pikërisht tek kjo fshehtësi, ndjenjat e gabuara, hedhin pushtetin mbi ne. Nëse guxojmë të themi të vërtetën mbi gjendjen tonë, problemet tona dhe, t'i pranojmë ato, ashtu siç janë, shkërmoqet ky pushtet. Njeriu del nga vetëngujimi dhe rikthehet në jetën sociale. Që t'a kuptojmë këtë filozofi, m'u deshën shumë ditë të errta me alkoolin. Por, ishte një arritje e pazakontë për mua, më madhështorja në jetën time. Të njihja vartësinë time nga alkooli dhe, të guxoja

të flisja hapur për atë, me cilindo.

Këtë vëndosa të bëj dhe, fillova menjherë. E harrova turpin. Ajo që unë, e kisha menduar të pamundur, menjherë u bë e mundur dhe, unë fillova të çlirohem nga vartësia e alkoolit.

Natyrisht, jo vetëm, jo pa ndihmën e specialistit. Unë fillova sot por, procesi ishte jo sot për nesër. Ishte i gjatë dhe i lodhshëm. Unë „vrava“ turpin, specialistët bënë punën e tyre.

Tani, pas tri vitesh, unë flas me cilindo për ditët e mia të errta me alkoolin. Madje, mbajë edhe leksione. Kjo për faktin se, mësova, sa e rëndësishme është heqja e maskës dhe, pranimi i realitetit, para të gjithëve. Dhe të dëgjosh me vemendje ata që të thonë: Ti, ia del! Ti nuk je vetëm!

Natyrisht që, edhe në gjendjen më të rëndë, ti nuk je vetëm por, alkooli është njëra nga llojet e drogave shumë të rënda.

Ka edhe nga ata që thonë, vetë e ke fajin. Kjo është një inorancë që duhet injoruar. Alkoolistët duhet të guxojnë të flasin, edhe përballë njerëzve injorantë.

Duhet të flasim. Të mposhtësh turpin do të thotë që, të guxojmë tjetrin për të na dhënë dorën. Që ata, t'a dëgjojnë trokitjen tonë dhe, të mendojnë se jemi gjallë.

Fakti që, shumë njerëz të njohur, të artit, politikës dhe shkencës, e kanë mposhtur vartësinë nga alkooli, tregon se, fitorja mbi vartësinë nga alkooli, është e mundshme.

Tani, unë jam sheruar, plotësisht dhe, që sot, jam në anën tuaj. Nuk kam ndër mend t'a ndëshkoj veten time për aventurat gjatë ditëve të errta me alkoolin. Ishin sjelljet e mia por, vendimet i merrte alkooli. Natyrisht që do të më duhet të paguaj pasojat por, ato nuk më trembin.

Tani që jam e lirë, e çliruar nga „pushtuesi“ alkool, ndiej shumë dhembje, nga ditët e mia të errta. Veç dhembjeve nga alkooli, ndiej dhembjet e poshtërim-it, të dhunës dhe keqtrajtimit nga të tjerët. Të atyre që më shfrytëzuan, duke përfituar nga pamundësia e ime fizike dhe psikike, për t'u mbrojtur.

Si do të sillem unë me ata?! Të gjithë i kam falur. Nëse unë do të vihem në rrugën e hakmarrjes, do të shndërrohem në një e vetëburgosur e përjetshme. Do të rikthehem përsëri në ditët e mia të errta por, jo të alkoolit, të hakmarrjes.

Më pëlqen shumë thënja e Nelson Mandelës: „Kur u hap dera e qelisë dhe, unë hodha hapin drejtë lirisë, urrejtjen dhe helmin tim, i lash aty. Ndryshe, gjithë jetën time do të isha një i vetëburgosur“.

# SOFRA E DUKAGJINIT- 2022

Me 28 Dhjetor 2021, në ambientet e Bar Restorant "Antika" u mbajt "Sofra e Dukagjinit-2022". Kjo datë është tashmë tradicionale dhe personifikohet si data e mbajtjes së ngjarjes më të rëndësishme folklorike të vitit. "Sofra" erdhi si një veprimtari pas një viti pushim për shkak të situatës në të cilën e gjithë bota po ndodhet, ajo e covid -19. E duket se të gjithë i kishte marrë malli për këtë organizim.

Si gjithmonë u mbajt nën udhëheqjen artistike të z. Lulash Brigja, i cili ishte kujdesur që nga përmbajtja artistike të mos i mungonte asgjë. E njëjta gjë për mjedisin, skenën, organizimin e publikut, që të kishin gjithë komoditetin e mundshëm te pronari i Bar Restorant "Antika", dhe njëkohësisht edhe drejtori tashme Shoqatës "Sofra e Dukagjinit", z. Vuksan Xhuri.

I gjithë veprimtaria filloi në orën 15:00, nën moderimin e znjsh. Klodjana Serraj, e cila për të disatën vit radhazi është pjesë e prezantimit të "Sofrës së Dukagjinit", dhe këtë vit për here të parë iu bashkua në moderim edhe znjsh. Pamela Mirashi.

Me muzikën me fyell, si në ambiente bëshke të freskët fillon, me vargjet që përshkruajnë mese miri tiparet e Dukagjinit; "Dukagjin, dashnia jonë":

*Fest' e gëzimë paç gjithmonë, / ty të ka Shqipja krenari / për tradita e burri.*

*Dukagjin vendlindja jonë, / sofrën sh-truar përgjithmonë, / me prit miqtë, me prit Shoqinë, / me prit djemtë kurdo që të vinë.*

Më pas, drejtuesi artistik kishte zgjedhur dy nga vlerat më të çmuara, të përcjellura brez pas brezi si pasaporta të folklorit Dukagjinas, qeleshja dhe çiftelia.

Qeleshen e ka pas çdo paraardhës i yni, gjyshërit tanë krenari në kokë, një moment prekës ky edhe për z. Lulash, që prezantoi këtë moment, duke thënë se qeleshen ë ka mbajt edhe babai i tij që ndërroi jete vetëm pak kohe më parë. Një moment prekës ishte edhe kur u prezantua çiftelia, duke theksuar se është pjesë e çdo momenti në gëzimet e secilit prej nesh e një ndër artistët, që ka kënduar me zemër me çifteli ishte edhe Mhill Çun Gjonaj, artist, i cili humbi jetën gjate vitit 2021. Ky moment do mbyllet me refrenin e këngëtarit Pëllumb Vatnikaj, këngë kushtuar pikërisht këtij artisti, i cili la shumë pas dhe do kujtohet gjithmonë, i cili me datën 20 janar 2022, u dekorua nga Presidenti i Republikës, zoti Ilir Meta, me dekoratën e larte "Mjeshtër i Madh", pas vdekjes, me propozim të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini".

Më pas do të vinte momenti i prezantimit të artistëve pjesëmarrës, që e bene këtë feste të paharrueshme.

E ata janë: Kole Hasani, Bardhok Lucaj, Gjovalin Shani, Gege Zefi, Gentjan Gropaj, Bledar Hysenaj, Noel Pjetri, Ndoc Fusha, Gjon Kosteri, Kolë dhe

Pashko Aramalli, Gjesh Fusha, Petrit Gjinaj, Prek Mrishaj, Bardhok Prebibaj, Gjergj Gjonaj, Gofile Papekaj, Aurela Mosheqaj, Kristjan Zalli, Zef Nika, Nikolin Përpali, Bardhok Mehmeti, Vjola Shqau dhe Zef Marku.



Ndoc Fusha, me Gjesh Fushën e Bardhok Palucaj

Si gjithmonë në "Sofrën e Dukagjini" kemi pasur miq të ftuar nga Mirdita dhe vjen për herë të parë këngëtarja Llesh Prenga. Nga Lezha dhe vjen malësorja bukuroshe, këngëtarja Nora Ndreu. Rishtazi për të shijuar këtë atmosferë festive janë dy këngëtare, Gjeshina Gjonaj dhe Vera Rama. Nga Kelmendi ka ardhur lahutari Luigj Gjerakaj, dhe çifti valltareve, si gjithmonë nga Kosova kishim

Channel", në Istog.

Pavarësisht se u zgjatëm në hyrje të emisionit, u zgjatëm shumë, por duartrokita më e ngrohtë i shkoi publikut, publikut të mrekullueshëm, që mbush çdo vit. Nëse jemi zgjatur pak në këtë

hapje të programit, është momenti për t'ju kërkuar një duartrokite për publikun e mrekullueshëm, që mbush çdo vit Ambientet e Bar Restorant "Antika".

I prezantuar të fundit, por jo nga rëndësia, sepse u ngjiten të parët në skenë. Ata i japin hijeshi dhe atmosferë Sofrës, grupi i vallevë nën drejtimin e Mjeshtër Altin Golemit, e hapën "sofrën" me një grup vallesh nga Shqipëria e Veriut.



Gjovalin Shani, me grupin e vallevë

të ftuar këngëtare dhe miq të "Sofrës së Dukagjinit", nga Istogu këngëtarja Ismet Demaj, nga Klina këngëtarja Fatmir Berisha dhe nga Peja këngëtarja Besnike Berdynaj. Fonia si çdo vit ishte nga Dj Lami dhe në tastiere mjeshtër Miri Zyrali.

"Sofrën Dukagjini" e përcollën për publikun në netët festive Televizioni "Rozafa" në Shkodër, Televizioni "Fontana" në Kosovë dhe Televizioni "Istogu

Është interesant fakti sesi këngëtarja mëkrahut, kjo thirrje, kjo piskame, si gëzimi që çonte krushqit në dasme dhe si krenari që çonte ushtaret në lufte, është një vlerë që nuk mungon kurrë në sofrat tona, për vlerën që mbart, por edhe për autoritetin që përfaqëson, në sofrë u soll nga Kole Hasani dhe Gege Zefi. Kënga e dyte erdhi si një kënge e prezantuar për herë të parë në "Sofrën Dukagjini", "N

'Dukagjin mirë kndoj grykëholla".

Kënga e trete, ishte me lahute, këtë here në një ton më të zbutur, kur dihet se me te i këndohet heronjve dhe trimave, në atë nate lahuta nëpërmjet Luigj Gjeraj, i këndoi shenjtores së njerizimit, që njohu Shqipërinë në të gjithë botën, Shenjtës Nënë Tereza.

Kole e Pashko Aramalli sollën këngën që na bashkon për dasma festa dhe raste gëzimesh, sidomos në kohet kur po largohemi të gjithë nga njeri-tjetri, kjo kënge një mesazh bashkimi.

Profesor Prek Mrishaj me plot merite për titullin, pas ardhjes nga Amerika ka marrë pjesë me shumë dëshirë në këtë mbrëmje festive.

Viola Shqau dhe Llesh Prenga do sillnin mesazhin i së cilës do të ishte, "Po kndojn' bashke motër e vëlla, Dukagjin e Mirdite, Porsi Shqipja me dy Kra' Buke e Besë dhe Tradite".

Kënga gjetje e këtij viti është padyshim dhe ajo që ishte bërë e suksesshme edhe në rrjetet sociale me titull "S'ka si Sofra e Dukagjinit" kënduar nga Gentjan Gropaj dhe Bledar Hysenaj, dy këngëtare të rinj me shumë perspektivë për të ardhmen, me këngët e folklorike dhe jo vetëm.

Nga Kosova tashme mikeshe e "Sofrës Dukagjini", Besnike Berdynaj, këtë vit kishte sjelle këngën "Po vjen dita e Bashkimit". Gjithmonë me dashuri të madhe për Shqipërinë si djallë me origjinë nga Merturi, Fatmir Berisha na solli "Mirese të gjej tokë e Shqipnise".

Dashuria është e pranishme kudo në çdo hapësirë të jetës tonë e një kënge nuk kishte si të na mungonte pa ia dedikuar asaj dashurisë së humbur, e sjelle nga Bardhok Mehmeti "Kush u ba shkak me u nda".

Një zë gjithmonë brilant në mbrëmje të tilla, që çiftelia e sharkia i këndojnë në dore e në zemër ishte i pranishëm edhe Gjergj Gjonaj.

Performancat artistike të saj janë pothuajse deri në perfeksion, Mbretëreshë e këngës Folklorike e quajnë disa, bilbil i zërit të pastër, me këngën "Oh moj zane", ishte kënga që këngëtarja Gofile Papekaj vendosi të na përshëndeste në "Sofrën Dukagjini".

Një moment solemn i sofrës. Ishte çasti i dhënies së disa vlerësime mirënjohjeje dhëne nga Shoqata "Sofra e Dukagjinit" me president z. Vuksan Xhuri dhe drejtues artistik z. Lulash Brigja.

Titujt ishin si vijon:

\*Z. GEGE ZEFI "MIRËNJOHJE, KRENARIA E BURRAVE TË SOFRËS TË DUKAGJINIT", me motivacion: "NJË PERFAQSUES TIPIK I BURRAVE TË SOFRËS SË DUKAGJINIT, FISNIK DHE I DITUR, KRENAR DHE FISTAR, TRASHIGIMTAR I DENJE I HISTORISË DHE KULTURES TONË. SOFRA E DUKAGJINIT KRENOHET



ME TË TILLË BURRA!"

\*Z. GJIN MARKAJ "MIRËNJOHJE. KRENARIA E DUKAGJINIT NË EMIGRACION", me motivacion: "PËR KONTRIBUTIN E DHENË NË KUADRIN E GRUPIMIT "VENDLINJA NA THERRET", ME QENDËR NË NJU-JORK-AMERIKË, DUKE MBËSHTETUR ME NDIHMA DHE INVESTIME BANORËT E DUKAGJINIT, POR EDHE PËR DISA PROJEKTE E INVESTIME QË JANË BËRË DHE PO BËHEN NGA KY GRUPIM. SOFRA E DUKAGJINIT JU FALËNDERON!"

\*Z. LULASH MARTINI, "MIRËNJOHJE, MUNDËSOR NDERI I SOFRËS TË DUKAGJINIT", me motivacion: "PËR KONTRIBUTIN DHE MBESHTETJEN QË KENI DHENE NDER VITE VEPRIMTARIVE KULTURORE E ARTISTIKE, NË VEÇANTI. SOFRËS TE DUKAGJINIT, PËR MIKPRITJE TË VEÇANTE NDAJ MIQEVE NGA KOSOVA, PËR BUJARI DHE SUPORT NDAJ ARTIT NË PËRGJEGJËSI!"

\*Znj. GOFILE PAPLEKAJ, "MIRËNJOHJE", me motivacion: "MBRETERESHE E KËNGES FOLKLORIKE, PËR PREFORMANCË TË SHKËLQYER ARTISTIKE SI KËNGËTARE E FOLKLORIT, MË PJESMARRJEN TUAJ NË VEPRIMTARI



Ndue Kola - Shosh, Ded Tefa - Gjuraj e Gegë Zefi - Shosh

KOMBËTARE DHE NDERKOMBËTARE, PER IMAZHIN EPIK QË I JEP SOFRËS SË DUKAGJINIT, ME ZËRIN TUAJ BRILANT".

Pas këtij momenti kaq solemn dhe të rëndësishëm të sofrës, programi, vijoj me këngëtarin Gjelina Gjonaj, e cila do vinte për herë të parë në "Sofrën Dukagjini".

Këngëtari Zef Marku, është një artist e ri, i cili ngadalë po i hedh hapat në fushën e muzikës, duke promovuar herepashere këngët folklorike popullore. Një ndër zërat premtues, për të ardhmen ishte edhe këngëtarja e re, Aurela Moshqej, e cila na solli një kënge me ritme vallëzimi.

Do te ishte radha për një nder këngëtarët që gjithmonë ka të pranishëm adhuruesit e tij, për të dëgjuar këngët e tij, Kole Hasani, i cili në këtë mbrëmje i ka kënduar Mehmet Shpendit.

Një nga talentet e reja dhe me një zë të bukur ishte edhe Noel Pjetri, i cili i këndoi valleve të bukura Shqiptare. Nen drejtimin e tij, Shoqëria kulturore artistike "BESA Shoshi", e ka pasuruar jetën folklorike të Dukagjinit. Shumë pjesëmarrje në veprimtaritë kombëtare dhe. më gjere, duke fituar çmime dhe vlerësime. Një falënderim i merituar për Z. Ndoc Fusha, i cili "Sofrën Dukagjini" e përshëndeti me një kënge për djemtë e Shoshit.

Grupi organizativ, ishte i kujdesshëm, që të sjellin në "Sofrën Dukagjini" nga të gjitha rrymat muzikore. por edhe nga të gjitha zonat. Një kartoline e bukur për këtë mbrëmje festive, ishte një dyshe valltare të ardhur nga Kelmendi, që sollën kërcimin malësorçe, të cilët kishin fituar edhe çmime, "kërcimi më i bukur".

Dhe menjëherë pas tyre, një djalë që jeton në mërgim, por si shumë të rinjë nga mërgimi, për festat e fund vitit dhe për "Sofrën Dukagjini" kthehen në vendlindje edhe ai është, Kristjan Zalli.

Një këngëtar i ri në moshe, i cili është kujdesur gjithmonë të sjelle tendencat e kohës, por duke e lidhur edhe me tradicionale. Ai e ka pasion që të këndoje për dashurinë dhe videoklipet e tij janë domethënëse, e për dashurinë këndoi edhe ne sofrën tonë. Ky është këngëtari Zef Nika.

Një ndër momentet që bënte skenën të tundej, ka qene momenti i valltarëve, te cilët kërcyen një valle me motive popullore nen mjeshtërinë e koreografit Altin Golemi.

Bilbili i bjeshkëve ai, qe në "Sofrën Dukagjini" ka shume adhurues, shumë miq, gjithmonë i duartrokatur erdhi në skenë këngëtari Bardhok Prebibaj.

Nora Ndreu është nga ato këngëtare që gjithmonë e ëmbël me zë të bukur dhe nuk I thotë kurrë jo "Sofrës Dukagjini". Me thjeshtësinë ëmbëlsinë që e karakterizon përcollti këngën e saj më grupin e valleve shoqërues.

Nga Kosova një këngëtar që ka kontribut dhe do përcjell nder breza ne muzikën folklorike të Kosovës është Ismet Demaj, i cili na përshëndeti, me

këngën më titull "Dasmat Shqiptare", me tekst të z. Lulash Brigja. Dhe pas tij do vinte këngëtari Gjelosh Fusha, i cili në respekt të miqve nga Kosova, në respekt të luftës dhe përpjekjeve të popullit të Kosovës për liri dhe për Flamur, Ai do të sillte këngën "Moj Kosove".

Një nga këngëtarët e shquar të Nikaj Merturi, i cili sjell në Sofrën tone, është Nikolin Përpali, publiku e do dhe duartrokotet, sepse ai e ngre sallën në këmbë, ai i fton djemtë dhe vajzat në piste për të kërcyer.

Në sofrë këndohen gjithmonë edhe këngët e burrave. Aty behet folklor i vërtete. trimave, legjendave e historisë, ashtu siç do ti këndonte edhe Gjon Kosteri.

Për Gjovalin Shanin, kurdo që ta ketë rrallën në renditjen e programit. ai mbetet me i suksesshmi, më i pëlqyeri dhe më i duartrokatur nga publiku, ai është një Apolon i folklorit, nder i kombit, vlere e shoqërisë tonë, madje edhe në momentin që prezantuesja, Klodjana po bënte prezantimin për këngën e tij, sapo u kuptua për cilin behej fjale, i gjithë publiku duartrokoti me brohoritje për të.

Talentet e reja vijnë të gjithë tek "Sofra Dukagjini", pasi ju ofrohet respekt, vlerësim dhe përkrahje pa kushte. Sot ata janë të rinjë në hapat e para, por jam e bindur se nesër do të jenë talente dhe të



Vjola Shqau, Llesh Prenga e grupi



Panela Marashi, Diana Bungu, Luash Brigja e Klodjana Serraj

suksesshëm. Një nder to edhe këngëtarja bukuroshe Emanuela Neçaj, që përsëri u shoqërua nga grupi i valleve. Të gjitha zonat i këndojnë vajzave të bukura, e për të bukurat e Shllakut na këndoi Vjola Shqau.

Dhe pas gjithë performancave ishte momenti për mbylljen e sofrës. Kënga përmbjllëse ishte me moton "Një këngëtar nga Kosova dhe një këngëtar nga Shqipërie te gjithë së bashku këndojmë këngën "Xhamadani vija-vija".

Pas gjithë këtij organizmi meritojnë një falënderim të veçante të gjithë mundësorët, të cilët në vijimësi e mbështesin këtë veprimtari domethënëse të muzike folklorike.

**Klodjana Serraj**

# Pathyeshmëria dhe madhështia e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut

Një përkthim i vyer nga suedishtja në shqip i të mirënjohurit Sokol Demaku



Viron KONA

**“Këtu pushon Kastrioti, ai, SKËNDERBEU! Sa i shkathët ishte ai! Sa i drejtë ishte ai!... Çfarë modeli për mbretërit!”**

Zannovich Stephan

(vijon nga numri i kaluar)


## Luftëtar i madh, por dhe diplomat i madh

Nga ky libër i Zannovich përkthyer nga z. Demaku, del qartazi se Gjergj Kastrioti-Skënderbeu e tregoi veten jo vetëm si një kryeluftëtar të përmasave evropiane dhe botërore, por edhe si një diplomat i mençur, duke vendosur aleanca, marrëdhënie dhe veprime diplomatike në interes të vendit të vetë, gjithnjë duke qenë realist dhe i ndërsjelltë në mbajtjen dhe forcimin e këtyre aleancave, duke i dhënë drejtimin e qartë dhe të duhur vendit të tij, drejt perëndimit, drejt Evropës. Me “Beslidhjen e princave shqiptarë”, më 1444, ai krijoi një përvojë që do të shërbente në shekuj si një mesazh i madh për bashkimin e popullit shqiptar, por dhe për popujt që luftojnë për liri, me devizën: “Të bashkuar, s’mund ta na thyej askush”.

Interesante ishin aleancat dhe marrëdhëniet diplomatike që ai vendosi me

shtetet evropiane, veçanërisht me fqinjët, por edhe më gjerë. Nuk duhet të harrojmë se, Evropa e asaj kohe ndryshonte shumë nga Evropa e sotme, kështu që edhe orientimi diplomatik ishte i ndërlukuar. Kjo, për faktin se në atë shekull, siç shprehen historianët dhe studiuesit, Evropa përbëhej nga qindra shtete, nga qindra principata dhe mbretëri, që ishin shpesh herë në luftë dhe konkurrencë e konflikte të rënda me njëra-tjetrën. Në ato kushte, shteti i vogël shqiptar, as që i hynte në sy fuqive evropiane, por, me kohë, pas fitoreve të bujshme të Skënderbeut kundër turqve, interesi evropian ndaj Shqipërisë dhe vetë Skënderbeut si një strateg i madh, sa vinte e rritej. Këtë e tregojnë marrëdhëniet e tij diplomatike me Vatikanin dhe letërkëmbimet e shumta, ndërkohë dhe vizitat dhe ndihmat e ndërsjellta. Ai fitoi besimin e Vatikanit dhe të tjetër papëve të Selisë së Shenjtë, të cilët embështetën Skënderbeun dhe luftën që ai zhvilloi me Perandorinë Osmane. Kjo mbështetje ishte aq e veçantë, në vitin 1457 Papa Calixtus III e shpall Skënderbeun “Kapiten-Gjeneral të Selisë së Shenjtë, duke i dhënë atij edhe titullin “Atlet i Krishtit”... Madje ishte planifikuar që nga Papa Piu II, Gjergj Kastrioti të shpallej në mënyrë solemne mbret i Shqipërisë dhe udhëheqës i koalicionit të gjithë krishterë në mbrojtje të Evropës prej osmanëve...

Aleanca të forta dhe lidhje diplomatike ai mbajti me Vladislavin e Hungarisë dhe gjeneralin e famshëm Janosh Huniadi, me Venedikun, me Raguzën (Dubrovnikun), me Mbretërinë e Napolit dhe me Alfonsin e Ferdinantin. Nga këto marrëdhënie dhe aleanca, Gjergj Kastrioti, krahas mbështetjes morale, pati edhe ndihma të vazhdueshme me ushtarë, me teknikë luftarake, ndihma në të holla... Por, po aq interesante janë edhe marrëdhëniet që ai krijoi me mbretërit e Milanos, Firencës, Sienës, Burgonjës, por edhe me



Sokol Demaku, poet, publicist, përkthyes i njohur

mbretërit e Francës, Polonisë, Spanjës etj. Sikurse, shprehin mençuri dhe diplomacitetërkëmbimet e Skënderbeut, deri edhe me armiqtë dhe kundërshtarët e tij, si ato me sulltan Muratin II, me të birin e tij sulltan Mehmetin (Fatihu-Ngadhnyesi), me mbretëre gjeneralë të fuqishëm të kohës etj. Me diplomacinë e tij, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu çeli edhe shtigje dhe krijoi fusha bashkëpunimi mes shteteve për të zhvilluar marrëdhënie tregtare, duke garantuar qarkullimin e lirë të tregtarëve dhe të mallrave në territoret shqiptare... Ai, si përherë, ishte i mprehtë, inteligjent dhe me aftësi parashikuese për veprimet që do të pasonin, sikurse shfrytëzonte çdo mundësi dobiprurëse, që i shërbente vendit e popullit të tij dhe qëllimit të lartë të lirisë.



## Davidi dhe Goliati një legjendë.

### Gjergj Kastrioti Skënderbeu një realitet i gjallë shqiptar.

Libri “Skënderbeu” i Zannovich, i përkthyer nga suedishtja në shqip nga Sokol Demaku, të entuziazmon, sidomos kur përshkruan betejat e pabarbartë në numër ushtarësh mes ushtrisë së Skënderbeut dhe armiqve të tij. Ndonëse shikonte se përballë kishte forca të shumëfishta në numër dhe të armatosura me mjetet më moderne të kohës, Gjergj Kastrioti nuk tërhoqej, nuk frikësohej, ai dinte se ç’bënte, sulmonte në kohën e duhur, në vendin e duhur dhe duke qëndruar vet trimërisht në ballë të betejës, duke dalë përherë fitimtar. Kjo metodë luftarake e tij, që, me një numërtë kufizuar ushtarësh, sulmonte një ushtri gjigande, sigurisht të gjithëve në botë kujton legjendën e betejës mes Davidit dhe Goliatit, ku, ky i fundit, gjigand nga trupi dhe pamja, fodull, arrogant dhe mendjemadh, mendonte se do ta copëtonte me një goditje të vetme Davidin trupvogël. Por, ndodhi krejt e kundërta. Ai u shtri sa gjatë-gjerë, vetëm nga një goditje mjeshtërore e Davidit... Kështu, betejat e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, mund të themi se ishin “të ngjashme” me këtë legjendë, veçse këto ishin të vërteta, reale, të dokumentuara dhe me jehonë në

të gjithë popujt e Ballkanit dhe të Evropës së asaj kohe. Parapëlqej të citoj këtu thënien e Aleks Budës, historian, ish-kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë: “Veprimtaria e Skënderbeut nuk është “një balon i fryrë”, siç është thënë, por një fakt historik. Këtu s’kemi të bëjmë me operacione banditësh nëpër male, por me një luftë gjigandeske, me përpjestime evropiane, që zgjati më tepër se një çerek shekulli dhe vuri përballë forcave vigane turke, popullin tonë të vogël”.

Sigurisht që, Gjergji kishte edhe një përparësi, kishte në ushtrinë e tij shqiptarët, arbërit, luftëtarë të dalluar dhe të rrallë për nga heroizmi, guximi dhe trimëria e tyre, por edhe nga aftësitë e mëdha luftarake. Ata preferonin një armatim të lehtë, krah dhe muskuj të fortë, kuaj të shpejtë dhe mjeshtëri në luftimet me shpatë, heshtë e shigjetë, por edhe trup me trup me forcat armike, ndërkohë që ndiqnin shembullin prijësit të tyre të pathyeshëm e me pamje madhështore, që nuk iu druajt asnjë betejë, asnjë duel, asnjë dyluftim. I referohem përsëri Volterit, kur shkruan: “Shqiptarët janë ushtarët më të mirë të atyre anëve. Skënderbeu diti mirë të shfrytëzojë trimërinë e tyre dhe terrenin e ashpër malor të vendit të vet, prandaj me pak trupa ai ndali gjithmonë armata të shumta turke... Shqiptarët janë epirotët e lashtë, të cilët janë aq luftëtarë sa edhe stërgjyshërit e tyre...” Mund të themi se te Gjergj Kastrioti-Skënderbeu përmblidheshin cilësitë më të mira shqiptare, vlerësimet që bëjnë për shqiptarët personalitete të shquara të kohërave. Duke qenë se flasim për veprën “Skënderbeu”, që na vjen nga Suedia, më vijnë ndërmend thënia e albanologut të njohur suedez Johann Thunmann (1746-1778), i cili ndër të tjera shkruan: “Qëllimi im nuk është që të shkruaj një histori të gjatë dhe të plotë. Përpjekjet e mia kanë qenë vetëm për të hedhur dritë mbi prejardhjen e shqiptarëve, ashtu sikurse shfaqet një numër i madh faktesh dhe dokumentesh të renditura në mënyrë kronologjike të cilat çjerrin erësinë, zhdukin konfuzionin dhe hedhin poshtë ato spekulime të paskrupullta mbi



këtë popull, duke u përpjekur që ta bëj të njohur këtë vend përgjatë gjithë historisë së tij si një komb, i cili është ndër banorët më të vjetër të Evropës dhe që kanë ditur të mbijetojnë, me gjithë fluksin e grekëve, romakëve, gotëve, sllavëve, frëngëve, italianëve dhe turqve...” Kurse anglezi i madh Bajroni (1788-1824), përfaqësuesi më në zë i romantizmit evropian e botëror, shprehet se “Shqiptarët janë raca njerëzore më e bukur që ekziston, trima më të fortë se kështjellat e tyre”.

Është interesante gjithashtu të theksojmë se, kur zhvilloheshin betejat me osmanët dhe fitoret e Skënderbeut vinin radhë njëra pas tjerës, kronikanët e kanë pasur zakon që të ulin numrin e vrarëve në ushtrinë e Skënderbeut. Duket se, zvogëlimet apo zmadhimet fiktive të numrit të vrarëve në luftime, jo gjithmonë të sakta, vijnë edhe nga vepra e Barletit, i cili edhe është kritikuar për këto “zvogëlime”, por, mbi të gjitha, faktet e fitoreve skënderbejane, pavarësisht numrit të vrarëve, kanë qenë të dokumentuara dhe të pranuar edhe nga vetë kronikanët apo arkivat osmane. Ashtu si Davidi, në historinë epike të tre mijë vjetëve më parë dilte fitimtar mbi Goliatin, ashtu dhe Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, me ushtri shumë herë më të vogla, arrinte të triumfojë mbi ushtritë gjigande të gjeneralëve osmanë të dërguar nga sulltanët e tyre, ashtu dhe mbi ushtritë që drejtoheshin nga vetë sulltanët, siç ishte rrethimi i parë i Krujës nga Murati II (1450) dhe dy rrethimet e tjera nga biri i tij Mehmeti (1466 dhe 1467). Siç shkruan Fan Noli (1882-1965): “Skënderbeu ka mbrojtur me sukses Krujën, kundër tre rrethimeve të Muratit II dhe Mehmetit të II, dy pushtuesve më të tmerrshëm të kohës, që kishin në dorë ushtritë më të forta të botës”. Kurse vet historianët ekohës e pranojnë se, vet Mehmeti II (1432-1481) ka thënë për Gjergj Kastriotin-Skënderbeun: “Kurrë s’ka për të dalë më mbi tokë një luan i tillë.”

Edhe në këtë vepër kushtuar Skënderbeut, që na vjen nga Suedia, mësojmë se Skënderbeu çdo veprim ushtarak, por dhe çdo veprim më përgjithës, e bënte të menduar mirë dhe të bazuar në informacione të sakta, në fakte e deri në detaje. Ai, me besnikët dhe agjentët e tij të shpërndarë nëpër perandori dhe në zemër të sarajeve sulltanore, njihte gjithë planet ogurzeza, që thurreshin në kuvendet e sulltanit, njihte planet e gjeneralëve osmanë, lëvizjet dhe rrugën që ndiqte ushtria estërmdhe shumëkombëshe osmane dhe reparatet e saj shumëarmëshe drejt Shqipërisë. Por, ai, duke qenë në të njëjta shkolla, nga më të mirat e perandorisë, me oficerët dhe gjeneralët osmanë, i njihte mirë ata, madje i kishte mundur qëkur ishin ende të rinj, në duela force dhe konkurse mençurie, ai ua dinte edhe trimëritë dhe aftësitë e fuqitë, por u njihte edhe huqet e dobësitë. Ndaj, duke i parë gjithnjë gjërat në kompleks, duke studiuar tipin dhe llojin e ushtrisë që po e sulmonte, duke nuhatur lëvizjet dhe taktikat e tyre, duke njohur armatimin që ata kishin, aipikaste pikat e tyre më të dobëta dhe, në rastin e kohës më të përshtatshme i sulmonte rrafshëm dhe shpartallonte, i detyronte të merrnin arratinë. Kështu e pësuan edhe gjeneralët më të mëdhenj osmanë, madje edhe në prani të sulltanëve të tyre, por, e pësuan edhe ata qënijnin mirë takti-

kat dhe strategjitë e Gjergj Kastriotit si: Ballaban Pasha, Hamza Kastrioti e Moisi Golemi.

### Portretizimi i karakterit dhe i pamjes së Gjergj Kastriotit - Skënderbeut

Libri ka skena të shkruara mjeshtërisht dhe në mënyrë tërheqëse për lexuesin. Përshembull, kur Mehmeti II, me sygjërim të Ballaban Pashës vendosi ta sulmonin Skënderbeun njëherazi me dy ushtri të ndryshme dhe nga dy drejtime. Skënderbeu, duke nuhatur qëllimin e

bibliotekën dhe arkivin skënderbejan.

Mehmeti II, duke folur për Skënderbeun, u tha gjeneralëve të tij:

“Unë do ta njoh gjithmonë Kastriotin në fytyrën e tij, por kurrë mbi supet e tij, sepse ai kurrë nuk më ka kthyer shpinën.”

I veçantë është veprimi i fundit i Gjergjit, i cili kur dëgjoi se një ushtri turke po sulmonte Shqipërinë, ai, kërkoi të vishte uniformën e tij luftarake, ngjeshi armët në brez, i hipi kalit të tij besnik dhe u vërsulsi rufe në betejë. Turqit, që besonin se ai ishte duke vdekur, kur dal-



armikut, veprimi guximshëm, duke u rënë atëherë kur ata s’e prisnin dhe i shpartalloi të dyja ushtritë, duke i detyruar të merrnin arratinë.

Po aq interesante dhe e padëgjuar është edhe historia e dy obortarëve, që ndodheshin në oborrin e Skënderbeut, e që, duke qenë tradhtarë, informonin sulltanin për gjithçka ndodhte në kampin shqiptar. Atëherë, sapo e mori vesh këtë tradhti, Skënderbeu i thirri të dy spiunët dhe i pyeti:

- Çfarë dënimi meriton shërbëtori që tradhton zotërinë e tij?

- Duhet t’i pritët koka, -iu përgjigjën ata.

- Epo, kokat tuaja nuk janë të denja për atë nder. Unë di gjithçka. Unë ju fal. Ju jeni shumë të këqinj për t’i shërbyer një zotërie, i cili çdo ditë rrezikon kokën e tij për të ruajtur jetën tuaj. Shkoni te Mehmeti. Nga kjo ditë ai është Sovrani juaj. Ju mund t’i thoni atij: Se Zoti e ruan kokën e Kastriotit dhe se unë s’e shpejti dua të vijë dhe t’i marrë kokën atij, jo në një mënyrë të pabesë, si bën ai, por në një mënyrë mbretërore dhe si një armik fisnik”.

Libri ka një mbyllje origjinale, ku blerojnë këshilla dhe mendime të arta të Gjergj Kastriotit. Duket se, në këtë rast, autori Zannovich ka vënë vetes detyrë të na e prezantoj Heroin tonë Kombëtar edhe si një dijetar, si një burrë shteti të mençur, që, siç ka qenë zakoni në kohët e vjetra, i jep të rinjve këshilla nga përvoja e tij. Edhe sikur vetëm ato këshilla të arta të kishte ky libër, do të ishte një vlerë e papërsëritshme, ndër kohë që libri është një pasurim i madh vlerash historike, shkencore, ushtarake e kulturore për

zakonshëm. Ai mund të jetonte ditë të tëra pa ngrënë ose pa pirë...”

Lexuesi i librit “Skënderbeut”, i shkruar nga Zannovich, me siguri do të ndjejë krenari edhe kur të lexojë fjalitë e fundit përmbyllëse të këtij libri: “Çfarë lumturie, që nderon reputacionin e një njeriu të madh, që pas tre shekujsh dhe më shumë, shikon sedrën e banorit, turkut udhëtar, të krishterit ose hebreut dhe iu shqipton bekimin e të njohurit, të relikeve dhe mbetjeve të tij të famshme; ata ngrihen, surprizohen, mahnitën, mrekullohen me

luan përkrenaren e Kastriotit, duke u valëvitur, ia mbathën nga fusha e betejës për të shpëtuar kokën...”

“Ai njeri i madh nuk ishte i tmerrshëm për askënd tjetër, përveçse për armiqtë e tij. Ai ishte një miknjerëz, i këndshëm dhe i sigurt për vartësit e tij. Ai ishte jashtëzakonisht bujar dhe i shpërbleu të gjithë ata që shkëlqyen në shërbimin e tij... I njihte emrat e pothuajse të gjithë ushtarëve të tij... Gjithmonë i angazhuar në luftë, ai dontetë lexonte. Komentet e Cezarit ishte libri i tij i preferuar. Ai dinte në mënyrë të përsosur gjuhën, zakonet dhe artet marciale të turqve. Ai gjithashtu fliste me lehtësi të madhe disa gjuhë evropiane...”

Na duket interesante në këtë vepër edhe portretizimi fizik që i bënë autori figurës së kryeheroit: “Gjergj Kastrioti kishte një ndërtim fizik trupi shumë të fortë. Njeriu mund të shihte kokën e tij të ngrihej mbi ushtarët e tij. Ai kishte një hundë shqiponje, lëkurë të bardhë të spërkatur me tone trëndafil, ballin e gjerë... Portreti që i ngjan më shumë, ngjan me statujën që kanë në Shqipëri, pastaj është ajo që kanë në Galerinë e Madhe në Toskana. Ai ka një mjekër të plotë, kryqin e Shën Gjjonit, të cilin e mbarti me përkushtim dhe çizmet everdha, që ishin zbukurime të tij të zakonshme.

Në kohën epushimit, ai pëlqente ta mbante kokën të zhveshur. Por, në fushë betejë, ai ishte i kujdesshëm për të veshur një “shami” me shumë pendë struci, për t’u treguar para ushtarëve të tij, se atje ku është koka e tij, atje do të ishte armiku. Thuhet se kishte diçka të pazakontë dhe të veçantë në fuqinë e Kastriotit. Ai dukej se kishte një natyrë tjetër nga njerëzit e

mbetjet e varrit të tij dhe thonë: Këtu pushon Kastrioti, ai, SKËNDERBEU! Sa i shkathët ishte ai! Sa i drejtë ishte ai!... Çfarë modeli për mbretërit! Çfarë angazhimi për atë që është pasardhësi i tij dhe shkrimtari i historisë së tij!

Faleminderit Sokol Demaku për përkthimin dinjitoz që na ke sjellë në shqip, për këtë përkushtim dhe atdhetarizëm të spikatur e frymëzues!

Shënim:

Nga kërkimet që ka bërë përkthyesi, z. Sokol Demaku, për të mësuar diçka më shumë rreth autorit të librit: “I madhi Kastriot ME LLAGAP Skënderbeu Mbreti i Shqipërisë, Duka i Madh i Epirit”, deri më sot del: Zannovich, Stephan ka lindur në Budva, Shqipëria veneciane, më 18 shkurt 1751 dhe ka vdekur në Amsterdam, Republika Hollandeze, 25 maj 1786. E kanë quajtur edhe me emrin Hanibal, ishte një shkrimtar i “Letrave Turke”. Ai ka shkruar në italisht, frëngjisht, latinisht, gjermanisht dhe serbisht... Giacomo Casanova e përmend Stefano Zannovich, i cili “bëri një vizitë në Vjenë nën aliat e Princit Castriotto d’Albanie. Nën presionin e autoriteteve, ai u largua në fund të korrikut 1784”, për në Poloni dhe, më vonë për Hollandë (Provincat e Bashkuara). Zannovich ka bërë një punë të madhe dhe me përkushtim rreth Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastriotit, kur ishte në Holandë dhe në Gjermani, pasi nxori në dritë librin e tij kushtuar Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Është interesant se si erdhi libri i Zannovich në Suedi, të përkthet nga Anders Zetterberg dhe të botohet në gjuhën suedeze, në vitin 1788, në Stockholm...

# KËSHTU ËSHTË E DUHET TË JETË NJERIU I MIRË!

- Posmortum për Tomë Kolë Rrushinin -

Tome Kole Rrushini pati le me 07.12.1939 në fshatin Mollë të Shoshit mbi një pìrg karbonatik, panoramik ndoshta më karakteristikun e strukturave gjeomorfologjike të Alpeve tona. Molla nuk është më pak as më shumë veç një akropol i një kështjelle fantastike natyrore, në të djathtë të rrjedhës së poshtme të lumit të Shalës, përballë masivit gjigand të Cukalit.

Tomë Kola u rrit mbi atë ballkon me fushëpamje të gjerë ku çdo ditë shihte si në shpatull të pulës gjithë Shoshin, pak më përtej shfaqej amfiteatri gjigant i Shalës. Dushmanin dhe Vilen mund t'i gjuante me gurë llastiku. Ndërsa sa herë të shikonte nga e majta ishte i "dënuar" të sodiste gjithë basorelievin e rrudhosur të malësisë së Pukës. Përballë gjithë kësaj hapësire kundërmuese, njeriu edhe po nuk lindi, kur zgjohet nga gjumi, behet poet, jo më kot mollëçorët përveç bukurisë së harlisur alpine janë shquar edhe si njerëz me humor të larmishëm tym për tym. Vocrrakut të malit lozonjar, plot shëndet si shtrria në pranverë ia prishi gjumin një batore e papritur pushkësh që ra si breshër mbi Mollën e rrethuar atë fund shtatori të vitit 1946. I tmerruar pyeti nënë Sosën, me të cilën flinte tue hedhë duart rrethi qafës:

- Dadë, për ku janë nisë këta miq që po qesin pushkë për shellak?! Rri aty biro janë miq të paftuar. "Aiiiiiii, paskan hetue se në Kashnjet strehohen koçakët. Edhe kjo morde na duhej"- tha me vete Sosja shtazënë, e cila pas të shtënave dëgjoi lëvizjen e bebit në bark. Po, po edhe ai ishte tmerruar dhe tronditur si gjithë Molla atë mëngjes të llahtarshëm që po agonte pas një nate sterrë pa hanë. Ndonëse e re kishte mësuar nga burri e nga të moçmit për vuajtjet që kishte pësuar ky fshat nga besa dhe buka e dhanë. Tragjeditë kishin pasuar njëra-tjetrën qysh nga koha e dauletit me Haxhi Begun, në kohën e malazezve me Mil Spasin, në kohën e Zogollit kur kërkohet koka e Gjon Marashit.

- "Pasha Krishtin edhe sot po kërkujnë kokën e bajraktarit dhe çetës se tij. Mos zot ma keq"-bani me vete sokolesha tue parandie një gjamë të tmerrshme që i drithëroi trupin dhe i kaploi shpirtin.

- Ku po shkon more njeri, - i tha të shoqit, i cili u çua jo hiç i druajtur?

- Po dal në oborr e shoh se ç'ka po bahet kështu, - ia priti Kola.

Në raste të tilla meshkujt e dinin përmendësh se duhej dalë stuj e bërë një me malin. Kur doli në oborr pa se ishte një kohë me vonesë. Shtëpisë së kushëririt dhe Kryeplakut Pjeter Kocës, ushtarët po i vinin flakën. Oborret e Mollës nxini nga ushtarë me mashina me gishta në gacë-keqe "Nuk jam fajtor. Pse po iku se ha një plumb pas shpine", - mendoi vet me veti Kolë Deda. Por llogaria i doli gabim, ushtarët e morën me forcë që tu tregonte shtegun e vetëm që të çonte te shpella e koçakëve. Nuk i kishte shkuar mendja se do të binte në një grackë të tillë. Bëri sikur u bind dhe filloi rrugën drejt

Çungjes. Ata ishin një togë dhe ky një i vetëm fillikat. "Qebesa, - tha me vete, - s'mu ka pre ora me i çue ku janë miqtë e gjithë Mollës. Unë po hidhem drejt greminës, po shpëtova mirë po nuk shpëtova,



ky paska kë në rrisku em. Sa të vonohen tu më ndjekë mue, kaçaket kanë me shkapërcye lumin. Shpejt si gjeja u iku ushtarëve dhe u hodh drejt gërxheve, por reagimi i toges së mbrojtjes qe fatal. Dy tre hapa pa hyrë në imsh të një breshëri automatiku ia bluzhditi këmbët dhe mbetet i zhytur mes gjakut. Komandanti i patrullës me theks tipik toskërisht pyeti njërin nga ushtarët

- He more e zuri apo jo?!

- Po po ja kemi sharruar këmbët kriminelit!

- Çfarë këmbësh ore, bjeri kokës, çfarë pret:

Krismat e tjera ia shoshatën kaptinën Kolë Dedës. Nga Rrethimi komunist i Mollës u vra Kolë Deda dhe u pushkatua Zog Mala. Tomë Kola ishte vetëm gjashtë vjeç kur mbeti jetim në shkrep të Mollës me gjashtë vëllezër. Deda më i madhi njëmbëdhjetë vjeç. Daka nëntë, Martini shtatë, Lini pese, Prela një veç e gjysmë dhe Gjoka ende pa le në bark të lokes. Me besim dhe dashuri në Zotin Sose Gjeloshja, një grua e fisme nga Dushmani u



Fotografi e organizatë së Rinisë së fshatit Pepsuj

bë zot e zonjë shtëpie, nënë e dashur dhe baba i rreptë, që i rriti me mund e sakrifica mbinjeriu për brezin e sotëm. Lokja kënaqej e rinohej kur shihte shtatë azgana nga trupi secili më i pashëm e i shëndetshëm. Shtatë djem të mbarë pa vese e gaztorë, të razijshëm, të pa thyer njeri me tjetrin dhe te nderuar për kudo që shkuan e jetuan për gjatë jetës së këndejme. Jeta e Tomë Kolës është një mozaik me kufinj të pandarë qartë mes xhamadanit, gozhupit leshgjatë, kostumit prej stofi dhe kravatës elegante. Bjeshka e ushqu, i dha shëndetin, shëmbëlltyrën, vitalitetin dhe mprehtësinë e saj. Pati dëshirë për shkollë kur shkolla nder male sa kish fillue të cazitej. Pa mbushë 10 vjet u largua nga shtëpia dhe shkoi në Konviktin e Xhanit. Kur u bë rrugës me Lekë Qaricën, Palë Bungun, Pal Mirashin, Zef Livadhin, Ndue Logun, Mark Gjergjin u lehtësua nga mërzia dhe lotët e nënës pikluen në kraharor, kur e përcolli deri në Drogobat.

Në Xhan ndoqi fillorën pastaj shtatë vjeçarën e vijoi në Konviktin Tom Kola në Shkodër. Një shtatëvjeçare sa e rreptë aq edhe cilësore që konkuronte po thuhet të mesmen e disa dekadave më vonë. I zgjuar, i shkathët, inteligjent, me kaligrafi piktoreske, i zhdërvdhët në matematikë, me dashuri dhe vullnet për të mësuar... Kushtet biografike nuk lejuan të vinte më tej, gjithsesi konvikti, shkolla, qyteti lanë gjurmë të dukshme në personalitetin e Tomës, që gjithë jetën sipas optikës time qe një hap para moshatarëve të vet. Për të gjithë ata që e njohën në rini, e kujtojnë një djalë hollak, më shumë i gjatë se i mesëm, i drejtë si ahat e Qaf Lisit, me konstrukt të mirëformuar, fytyrëqeshur, sy të errët, flokë të zi dhe të dendur, të cilët çuditërisht e tradhtuan përpara kohe, por Toma ishte nga të paktët njerëz që i shkonte rënia e pjesëshme e flokëve, madje në vitet e moshës së tretë e bëri më burror ndonëse mote pati shumë në kandarë se sa tregonte paraqitja e tij. Ka mbi 55 vite që e njoh dhe kurrë nuk e pashë të veshur shkel e shko, por me shije dhe shumë pastër. Pëlqente këmisha të

bardha me xhaketa blu ose të zeza. Nuk kishte shans të vishte këmishë të rrudhosur as me jakë të pa pastër. Këmisha e bardhe është paditëse e madhe. Molla ishte larg fshatrave të tjerë, kur nuk kthehej brenda dite ose hiqte këmishën ose vinte rreth qafës faculetë. Pas vdekjes së Tomës kam pa një fotografi të Organizatës së Rinisë së fshatit Pepsuj-Mollë e vitit 1964. Jeta në ato vite rridhte pa zhurmë, pa bujë dhe me pak gjurmë në celuloid jo si sot që në çdo hap mund të besh një shkrepje. Tashmë ajo foto ka vlera arkivore të një fototeke. Të gjithë të rinj e të reja si vëllezër dhe motra të veshur thjeshtë, por bukur, një pjesë sot janë në moshën e tretë tashmë gjyshër dhe gjyshe, një pjesë nuk janë më këtu, por në jetën e pasosur.

Tomë Kola gjatë gjithë jetës u shqua si aktivist dhe veprimtar i mirë shoqëror, ishte aktivist i rinisë, i frontit, por edhe brigadier dhe drejtues i mirë për shumë vite. Biografinë e pati gurë të varur në qafë, por ishte korrekt, i zgjuar dinte te ruante distancën, fliste pak dhe vetëpërmbahej edhe kur e pickonin anzat. Qe njeri me karakter, i thjeshtë, shumë komunikues, as pak servil dhe kurrë nuk u përdor, siç u përdorën jo pak nga shtresa e tij. Punoi me mënd më shumë se me krahë, por dinte të bënte mirë të gjitha punët e bujkut, jo kush më mirë se ai krasite hardhitë dhe pemët. Qetë i ngante gjithë stil mjeshtërore, arën e qëndiste në prashitje, livadhin rruante me kosën e tij anxë

Toma ishte një krye-krushk, që nderronte krushqinë, ishte një kuvendar që lezetonte bisedën, por edhe zjarrfikës i shfrimeve përvëluese. Ditën të bënte humor, por urrente talljen dhe përçmimin. Ishte i shëtitur, si ishte vendi dinte te bënte kuvendin. E njihte kanunin më mirë se shumë nga ata që rrinin rrok e puth me të dhe u benë hipokrit ose donkishot. Toma ishte një amortizator i mirë mes të vjetërve, që nuk lëviznin nga cungu dhe të rinjve kryepërpjetë. Më asnjërin skuadër nuk rreshtoj dhe të dy palët e donin si arbitër. U shqua si një drejtues i shkathët dhe i talentuar si në raste rrufesh gjamatore dhe gëzime arguese lumturie.

Toma e çmonte dhe e vlerësonte jetën. Qe duhanpirës i vjetër, por duhani nuk e mposhti. Mbante një kuti elegante gjithmonë më një soj të zgjedhur efshndjellës duhani. Adhuronte gotën dhe gratë, por kurrë nuk u robërua prej tyre. Për kohën që jetoi u mirë-ushqye, në festa, dasma, gëzime, e shëtitje te pafund kurrë nuk shkoi me lugë në brez. Së bashku me vëllezërit u rritën jetimë, por përparuan shpejt dhe i hynë njëri tjetrin ndër krahë, ndertuan në maje të Mollës një shtëpi dykatëshe si kurrkund shoqja. As në Mollë, as në Pepsuj, as në Shosh nuk gjendeshin as dy vëllezër lere me shtate, por kaq të dashur e lidhur njeri me tjetrin. I pati tronditë rendë vdekja në lule të moshës e Martinit ndër trëndafiloret më të shkëlqyer të djelmisë së Shoshit. Ndoshta vetëm pas

# Rron tradita në Malësi të Madhe

Më ka mbetur në mëndje një shprehje e mënçur, e cila thotë se: “Sekreti i suksesit është këmbëngulja për arritjen e qëllimit”, gjë për të cilën mund të them me bindje se, në veprimtarinë e datës 20 dhjetor 2021, në Bregun e “Shpellës së Frashnit”, SUKSESI u finalizoi mrekullisht bukur.

Një veprimtari edukative e veshur me një dinamikë vlerash kulturore, disi të fjetura në këtë kohë evolucionit ndërkulturor, bënë që jehona e saj të marrë dhenë e të shpërndahet si era bjeshkëve të malësisë. Një sukses që nuk përshkruhet me fjalë, në të cilin pata fatin të jem njëri nga prezantuesit e tij. Një mundësi dhe surprizë e bukur nga e cila mora jo vetëm kënaqsi, por edhe motivim të vijoj pa u ndalur dhe me vetbesim, rrugën në time drejt suksesit.

Një veprimtari e mirëorganizuar, të cilin fare mirë mund ta quaj si një punë e mirëfilltë institucionale pas së cilës qëndrojnë organizator profesionist. Ku për hirë të vërtetës, kjo veprimtari ishte një realizim i Shoqatës Kulturore “Xhubleta e Alpeve Shqiptare” në bashkëpunim me Gjimnazin “Dodë Kaçaj” Bajzë, nën kujdesin e mësueses së përkushtuar Florina Laçaj dhe mbështetjen e veçantë të Kryetarit të Bashkisë Malësi e Madhe, z. Tonin Marinaj.

E gjithë veprimtaria kishte fokus kryesor folklorin dhe traditat e malsisë.

- Konkurim për “Vallen e Logut”.
- Konkurim për interpretimin më të mirë në gegnisht.
- Konkurim për pikturën më të reali-



vdekjes së parakohshme të dy të mirëve (Daka mjeshtër i talentuar që kurë nuk e çoj keq me kënd dhe Deda shumë popullorë shumë i dashur i pashëm dhe festar) u kuptua se Toma ishte babaxhani i atij barku frymëplot të Kolë Dedës. Prej vitesh e vitesh nipat dhe mbesat e respektin ndoshta më shumë axhën Tomë se baballarët e tyre. Me të flisnin lirshëm dhe i shpreheshin për gjithçka. Ndonëse

nuk pati fëmijë, që plotësisht i përkushtuar sikur të gjithë ti kishte bijë të tij dhe ndër ta nuk diti të bënte kurrë dallime.

Fati martesor i buzëqeshi vonë në vjeshtë, por i erdhi si vegim i mirësisë dhe kjo që File Gjergja një femër fisnike shembullore, bijë e një familje të sojshme nga Toplana. Përmbi dy dekada rrezatoi flaka e tyre aguese dashurore model harmonie dhe mirësie, deri sa me

datë 16. 12. 2020 Toma shkoi atje ku e thirri Zoti pranë vetit. Shkoi 81 vjeç i paplakur pasi kishte përcjellë katër vëllezër, por shumë shpejt brenda disa muajve e ndoqën me vrap edhe Gjoka e Lini, duke u bashkuar të gjithë në amshim. U rritën, u plakën dhe deri sa vdiqën mbetën gjithnjë vëllezër e shokë shembullorë të pandarë.

Vdekja e Tomë Kolës i bani keq jo

zuar me tematikë folklorin.

- Panair me gatime tradicionale.

Me çmime e vlersime të gjykuara nga një juri profesionistësh, ku e veçanta e gjithë këtij konkursi ishte kriteri për pjesëmarrësit “të veshur të gjithë me veshje kombëtare”, me çakçir e me xhubleta. Konkursi “Rron tradita n’Malësi t’Madhe” kishte për qëllim zbulimin dhe vlerësimin e talentëve të reja të kësaj krahe në fushën e artit dhe të kulturës si dhe mbajtjen gjallë të traditës së bukur dhe më shumë vlera të Malsisë së Madhe.

Gjatë zhvillimit të konkursit ranë në sy talente të shumtë, të cilët në fund u vlerësuan me çmime të ndryshme si monetare ashtu dhe simbolike.

Një juri e përbërë nga përfaqësues të folklorit të zonës si: rapsodi Pretash Nila, përfaqësuesi i trashëgimisë gojore Gjon Runa, si dhe përfaqësues të kulturës nga Bashkia Malësi e Madhe, të cilët vlerësuan talentet e reja në fushën e kërcimit, pikturës dhe interpretimit të poezisë.

U vlerësua e u ndan keto çmime:

Në kërcim:

- Çmimin e parë “kërcimi më origjinal i vallës së logut” e fituan Kristjan Bujaj e Fatjon Gjerka;

- Çmimin e dytë e fituan Ema Shabaj e Lorenc Bujaj;

Në pikturë me tematikë pasqyrimin e folklorit të zonës:

- Çmimi i parë u fitua nga Valentina Gjeloşi.

- Çmimi i dytë Izabela Isufi.

Për interpretimin më të bukur të poezive me dialekt gegë:

- Çmimin e parë e fitoi Eduard Hysaj.

- Çmimi i dytë u fitua nga Amela Rruka;

- Çmimi i tretë u fitua nga Majlinda Bujaj.

Në fund të këtij konkursi, organizatorët ftuan pjesëmarrësit të shijonin ushqime tradicionale të zonës, në panair ushqimorë të përgatitur nga nxënësit e shkollës “Dodë Kaçaj” Bajzë.

E gjithë veprimtaria, si rrallë herë u ndjek nga një numër i konsiderueshëm spektatorësh vëndas dhe të ftuar, të cilët i dhanë ende më shumë kuptim dhe emocion lundrimit të kësaj gjenerate në traditat e lashta të Malësisë në Bregun e “Shpellës së Frashnit” në Bajzë të Kasëratit.

**Nga Silvester Durgaj**

*Shkrel, Janar 2022*

vetëm familjes, por edhe Mollës, Pesumajve dhe Shoshit se na duhej me e pa si shëmbëllim i mirë i kores së moçme, që po ikin pa u ndalë.

Tomë Kola e përgatiti rrasën e varrit të vet. Nuk kërkoi epitete as lavde në jetë, por e shkroi me vuajtje e heshtim. Kështu është e duhet të jetë njeriu i mirë

Pushofsh në amshim Tomë Kola!

**PRELË MILANI**

# NË DORË PUSHKËN E LIRISË, NË GJOKS ZJARRIN E POEZISË

Refleksione për librin me poezi “PUSHKA E TYRE, KUSHTRIM LIRIE”, dhe për veprimtarinë atdhetare të luftëtarit të UÇK-së, Genc Sefa - “Lushnja”

Autori i librit me poezi “PUSHKA E TYRE – KUSHTRIM LIRIE”, është luftëtari dhe komandanti i UÇK-së, Genc Sefa-“Lushnja”, i cili, ndonëse i dha luftës çlirimtare të Kosovës, mundin, djersën dhe madje edhe pjesë të trupit të tij, sot gjendet i ndaluar e i dënuar nga gjyqi politik i sllavo-maqedonasve dhe mercenarëve e tradhtarëve në shërbim të tyre.

Genc Sefa, me pseudonimin e Luftës Çlirimtare, “Lushnja” është nga Lushnja, qyteti në kërthizë të Shqipërisë londinaze. Gjer në vitin 1998, Genci nuk kishte qenë asnjëherë në Kosovë. Kufizimet e para nëntëdhjetës, shkollat që duheshin mbaruar dhe detyrat e para funksionale në Ushtrinë shqiptare, e kishin penguar të kapërcente kufirin artificial shqiptar-shqiptar në qafën e Morinit. U deshën vitet e zjarrta 1998-1999 kur nisi lufta e hapur e UÇK së famshme kundër regjimit serb, që Genc Sefa me përgatitjen dhe uniformën e ushtarakut, të kapërcente kufirin dhe t’u bashkohej luftëtarëve, me një objektivi: Të çlironin tokat tona amtare nga pushtuesit serbo-barbarë dhe të realizonin amanetin e rilindësve tanë, për Bashkimin Kombëtar.

Fund vitet nëntëdhjetë e gjetën Genc Sefën, në radhët e Ushtrisë Popullore Shqiptare. Ishte diplomuar në Akademinë e Mbrojtjes, titulluar oficer dhe komanduar në repartet e Gardës së Republikës. Trazirat e vitit 1997, që shembën shtetin, ekonominë dhe ushtrinë e Shqipërisë, ndërprejnë edhe karrierën ushtarake të Genc Sefës, i cili mërgoi përkohësisht në Greqi, si shumë kolegë e bashkëkombës të tij.

Por planet për të nisur ndonjë punë si emigrant, do të liheshin mënjane. Në Kosovën martire u ndez lufta për liri. 7 Marsi i vitit 1998, që shënon luftën dhe sakrificën e Adem Jasharit me gjithë pjesëtarët e familjes së tij, do të ndryshonte jetën e shqiptarëve në Kosovë dhe jashtë saj. Genc Sefa, që gjendej në ishullin Santorini të Greqisë, sapo dëgjoj lajmin për sakrificën e familjes Jashari, u nis për në Kosovë. Nuk mund të bënte ndryshe. Ai ishte rritur dhe edukuar në një familje patriotike. Paraardhësi i tij, Nebih Sefa, në 28 Nëntor 1912 kishte qenë në krah të Ismail Qemalit, kur nënshkroi Aktin e Madh të Pavarësisë. Nga ana tjetër, akti heroik i Komandant Adem Jasharit, ishte sinjali i Thirrjes së Atdheut. Aq më tepër kjo për një ushtarak, që Atdheu e kishte përgatitur për këtë ditë.

Jeta dhe veprimtaria luftarake e Genc Sefës në radhët e UÇK-së ishte tepër intensive. Falë përgatitjes së tij ushtarake, u inkuadrua në operacionin “Shigjeta” në Pashtrik, një njësi kjo zbuluese e vëzh-

guese. Më 6 qershor 1999, në një nga përpjekjet me ushtrinë dhe paramilitarët serb, plagoset rëndë, duke humbur një pjesë të këmbës. Pas luftës, ndonëse me proteza në këmbë, vijoi të japë kontributin si oficer në trajnimin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Në të njëjtën kohë, mbaron Fakultetin Juridik, dega Kriminalistikë, specializohet në kuadër të trajnimeve të NATO-s në Kosovë, duke realizuar 12



çertifikime të ndryshme si instruktor bazik e deri tek i avancuar për trajnimin e Shtabeve dhe Komandave.

Në vitin 2000 inkuadrohet në UÇPMB (Ushtria Çlirimtare e Preshevës, Medvegjës e Bujanocit), fillimisht si komandant i qendrave stërvitore, e më pas në përgatitjen e vijave të mbrojtjes. Me kërkesë të Shtabit të Përgjithshëm, kalon në zonën operative të Karadakut, për të ngritur e drejtuar Brigadën e 115, që mbante emrin e Dëshmorit Nijazi Azemi. Pas përfundimit të luftës në Luginë, rikthehet tek Trupat e Mbrojtjes së Kosovës, si instruktor i lartë i Qendrës Simulative në Komandën e Trajnimeve dhe të Doktrinës, deri në transformimin e saj.

Përpjekjet për Liri e Bashkim Kombëtar, Genc Sefa nuk i ndali për asnjë çast. Më 9 maj 2015, tashmë si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, Genci me shokët e tij luftëtarë, u përplasën me forcat speciale sllavo-maqedonase. Në këtë përplasje të armatosur, humbën jetën 10 luftëtarë të UÇK-së, ndërsa nga pala maqedonase 8 pjesëtarë të forcave speciale dhe mbi 37 të plagosur. Aktualisht Genc Sefa, me pseudonimin e luftës “Lushnja”, së bashku me shokët e tjerë luftëtarë të UÇK-së, vuajnë dënimin e dhënë nga Gjykata famëkeqe sllavo-maqedonase, për luftimet në “Lagjen e Trimave” në Kumanovë, më 9 maj 2015, luftime të cilat vunë në lëvizje faktorin ndërkombëtar dhe vetë BE, për të kuptuar kërkesat e shqiptarëve ndaj regjimit sl-

lavomaqedon në Republikën artificiale të Maqedonisë së Veriut.

Në dokumentet e historisë së UÇK-së, midis të tjerave, për Genc Sefën është shkruar:

“I burgosur nga regjimi sllavo-maqedon, veprimtari i çështjes kombëtare, luftëtari i lirisë në UÇK dhe eprori në UÇPMB dhe TMK; invalidi i luftës, Genc Sefa-Lushnja, është një intelektual i formuar me kohë, ka kaluar shumë sfida si shumica e luftëtarëve të Kosovës. Gjithmonë në gatishmëri për të kontribuar me dijen, guximin dhe përvojën e posaçme si Ushtarak Karriere e Veteran i Luftërave, njohuri e përvojë të cilat i ka vënë në shërbim të Atdheut”.

Luftëtari Genc Sefa – “Lushnja”, siç e treguam edhe më sipër, qysh me 6 qershor 1998, kur mbërriti për herë të parë në Kosovën e Shqipërisë, e deri më 9 maj 2015, kur u burgos nga shteti sllavo-maqedon, nuk u shkëput për asnjë çast nga shokët e tij të UÇK-së. Ai edhe çerdhen e familjes së tij e ngriti në Ferizaj. Ishte jo vetëm admirimi për këtë pjesë të Atdheut të tij, së cilës iu përkushtua gjer në sakrificë supreme, por ishte edhe angazhimi i tij i drejtpërdrejtë në çështjen kombëtare, veçanërisht në përgatitjen e forcave të ardhshme të Republikës së Kosovës. Dhe mbi të gjitha, për vijimin e luftës sipas amanetit të Dëshmorëve dhe të Bac Ademit për bashkimin kombëtar.

Për fat të keq, objektivi dhe Amaneti i Komandantit legjendar, Adem Jashari, për çlirimin e gjithë trojeve shqiptare dhe realizimin e bashkimit kombëtar, përkohësisht u ndal. Shkak u bë politika e vjetër dhe e re e politikanëve dhe zyrtarëve evropianë, ndihmuar kjo edhe nga tradhtarët dhe bastardët e racës sonë, të cilët, jo njëherë, janë bërë pengesë në rrugën dhe luftën që na trashëguan Rilindësit tanë të mëdhenj. Themi përkohësisht, sepse lufta e shqiptarëve do të vijojë, gjer sa ta realizojnë e ta shkruajnë të plotë togfjalëshin domethënës, “BAC U KRYE”!

\*\*\*

Në situatën e krijuar, Luftëtari Genc Sefa, gjendet në pamundësi të vijojë realizimin e amanetit të Komandant Adem Jasharit. Por ai, ndonëse i izoluar, ka gjetur mundësinë t’i shërbejë çështjes pa u ndalur. E vetmja mundësi aktuale e tij, është të japë kontributin në evidentimin dhe shkrimin e historisë së luftës më të re të popullit shqiptar, për liri, pavarësi dhe Bashkim Kombëtar. Dhe këtë kontribut, ai ka zgjedhur të na e përcjellë nëpërmjet poezisë, gjinia më frymëzuese e lëmit të krijimtarisë artistike.

Ushtaraku i nivelit të lartë, Genc sefa, nuk njihet si poet, apo lëvruar i ndonjë gjinie tjetër të letërsisë, pos provave të

vogla e të thjeshta që çdokush në moshën e rinisë, tenton të hedhë në letrat e artit, përjetimet që merr në punë e në jetë. Por poezitë që ka sjellë nëpërmjet librit të tij, tregojnë se njeriu i luftës, siç janë ushtarakët, diku në një qoshe të shpirtit, ruante edhe ndjenjat dhe përvijimet e bukura të artistit, të poetit. Ishte kjo arsyeja, që unë shkruesi i këtyre radhëve, mbasi lexova poezitë e tij, zgjodha të vë në krye të këtij shënimi titullin: “Në dorë pushkën e Lirisë, në gjoks zjarrin e poezisë”! Dhe besoj se nuk kam gabuar. Lexuesit, kur ta kenë librin e tij në dorë, do të më japin të drejtë.

Genc Sefa – Lushnja, që në vogëli u mëkua më patriotizmin dhe dashurinë për Atdheun. Ishte linja kryesore e trashëgimisë ndër brezat e familjes e të fisit të vet, të paktën që nga paraardhësi Nebih Sefa, nënshkruesi i Aktit të madh të Pavarësisë me 28 nëntor të vitit 1912. Ky zjarr patriotik dhe atdhedashës, ishte ushqyer më tej në shkollat që kreu, veçanërisht në atë ku dalin kuadrot e Ushtrisë, mbrojtësit më të parë të Atdheut, për t’u vënë në provën e zjarrit, në vitet dhe ditët e stuhishme të luftës për çlirimin e Kosovës.

Është ky pozicion i autorit, që ka ndikuar në realizimin e poezive me mjaft art bashkëkohor, por veçanërisht me përmbajtje të lartë atdhetare. Libri “Pushka e tyre, kushtrim lirie”, na sjell poezi të thjeshta, por me plot kolorit, ndjenjë e art të vërtetë. Mbi të gjitha, libri në fjalë është një dëshmi e gjallë e asaj që ka ndodhur në vitet 1998-1999, kur populli i krahinës shqiptare të Kosovës, ngriti krahun e saj të armatosur, UÇK-në, dhe realizoi epokën më lavdiplote të shqiptarëve në kapërcyell të shekullit të njëzet.

Në libër janë radhitur mbi njëqind poezi, të cilat ngërthejnë jo vetëm personazhe të UÇK-së, por kapin pothuaj gjitha historinë shumë shekullore të shqiptarëve, duke mos lënë mënjane, edhe disa fenomene të ditëve të sotme, ku autori mban qëndrime të hapura kritike. Në substancë të të gjithë poezive, evidentohet postulati tashmë i njohur dhe i vërtetuar nga historia, se “Liria nuk dhurohet, por fitohet”. Ashtu siç jepet, pothuaj në shumë poezi, mesazhi për bashkimin kombëtar, që është dhe mbetet objektivi kryesor i shqiptarëve.

Pjesën më të madhe të poezive, autori ua kushton Dëshmorëve dhe luftëtarëve të UÇK-së, të cilët në mjaft raste i ka njohur personalisht, e me disa ka qenë në një vijë zjarri gjatë luftimeve me forcat serbo-sllave. Poezitë kushtuar dëshmorëve, shkruar me shumë dashuri e nderim, janë edhe një material shumë i nevojshëm, si për vete të rënë, të cilëve populli u ka

# LAMTUMIRË NDOC MULAJ, AMBASADORI I MALEVE TONA!

Alfred Lela

Përcolla një mik të dashur sot. Ndoc Mulajn, një 53 vjeçar nga Mulajt e Mërturit, katolik i fiseve të maleve tona të Veriut, i apasinonuar me majat, qafat, kalimet, shtigjet, krojet, lumenjtë dhe shpellat, për të cilat ai ngulmonte se janë bira... sepse kështu i quajnë në anët e tij.

Babai i Dejvit dhe Deas, i shoqi i Violetës, vëllai i Markut, Sokolit, Agimit, Liries, Meritës dhe Dafinës.

Ndoci ishte diçka më vete për shumë njerëz, por unë dua të flas për atë çka është për mua. Ai ishte, pra, burri që, përveçse i donte malet, i kuptonte ato, i dëgjonte kur pëshpërisin kode apo heshtje të veçanta, që vetëm malësorët i kapin. Ndoci ishte filozof i maleve, jo një ekskursionit, shkelës i rëndomtë i tyre. Si mund ta kuptosh ndryshe një malësor, që i ka lindur krye në malet e madhërisme dhe njëheri të ashpra të anëve të tij, që u kthehet atyre me ngulm në moshë të rritur. Jo vetëm me pasionin e rinjohjes së tyre, por edhe me dëshirën për t'ua hapur ato syve, zemrave dhe mendjeve të të tjerëve.

Kush shkon në male e di se shumicën e shtigjeve të tyre i ka markuar (shenjuar) Ndoc Mulaj. Nga Livadhi i Hamzës në Tërbun, nga Livadhet e Hapura në Cukal, nga Bicaj në Krrab, nga Lumi i Shalës te Guri i Blinit të Lekës, e më tej deri në Theth, përgjatë Lumit të Shalës, apo më lart në Mollë të Shoshit, është Ndoc Mulaj me dorën dhe filozofinë e tij. Nëse iu bie rruga andej, boja e shiritave bardhë-kuq në gurë, në trungje ahesh apo lisash, është prej dorës së tij. Kur shihni tabela shtigjesh malore të specifikuar hollë, me drejtime dhe kilometra, sa në Shkodër, Malësi të Madhe, Pukë apo Tropojë, është si të keni Ndoc Mulajn, dhe shpirtin e dalë nga trupi i tij pasditen e së enjtes së 30 dhjetorit, t'ju prijë për në zemër të maleve.

kënduar e do t'u këndojë këngë; por ato janë një material i domosdoshëm dhe shumë autentik për shkrimin e historisë së kësaj lufte, në mënyrë reale dhe me të gjitha përmasat e saj.

Poezitë për dëshmorët, autori i kombion apo i alternon me poezi për Heronjtë e Kombit, që nga lashtësia, e gjer në kohët moderne. Dhe këtë ai nuk e bën nga rastësia, por për të treguar se midis dëshmorëve dhe heronjve të kombit tonë, të të gjitha periudhave historike, ka një lidhje organike, një trashëgimi të pandërprerë, çka i siguroi kombit tonë mbijetesën përballë furtunave të kohës, duke ruajtur me fanatizëm dinjitetin dhe identitetin e tij kombëtar. Temperamenti epik dhe luftarak që shoqëron poezitë, kushtuar ngjarjeve historike të popullit shqiptar dhe figurave të shquara të kësaj historie, balancohet me lirikën e poezive, kushtuar vendlindjes, dhe veçanërisht ato që ia dedikon prindërve të tij në Lushnje, dhe fëmijës në Ferizaj.

Luftëtari i lirisë, Genc Sefa – “Lush-



Ndoci ishte i drejtë si malësorët, në shtat dhe në fjalë. Brenda tyre mund të gjeje, jo rrallë, ironinë e hollë të njeriut që e ka parë jetën nga lartësitë e gjeografisë së vendit të tij dhe historisë së vet personale, të cilat nuk lejojnë fjalë të tepërta dhe akte të pakta. Ai e përdorte këtë ironi edhe për të mbuluar padijenitë e tij ndonjëherë. Si, për shembull, kur ktheheshim nga ngjitja në malin e Krrabit dhe, pasi kaluam Pukën, e pyeta “si quhet ai fshati atje në shpat të malit, Ndoc”. ‘As nuk më intereson fare’, ma priti. Ishte mënyra e tij sarkastike për të thënë ‘nuk e di’. Dhe Ndoci nuk ia lejonte vetes të mos dinte diçka për malet tona, fiset, ujrat, befasitë dhe tundimet e tyre.

Ndoci ishte mishërim i ironive të holla edhe brenda jetës së vet. Ai kishte probleme me zemrën dhe, pas një ndërhyrjeje, mjekët i kishin implantuar dy unaza koronare. Megjithatë, me krenarinë, unazat në zemër, dhe dashurinë për malet, nuk iu nda ngjitjeve dhe zbritjeve nga ato lartësi

nja”, na dhuron një cikël me poezi, liriko-epike, shkruar në kushtet e izolimit politik dhe fizik, me të cilin u drejtohet gjithë shqiptarëve me mesazhe të fuqishme për Lirinë, për çlirimin e trojeve shqiptare të pushtuara nga shovinistët fqinj, për demokracinë, lumturinë dhe begatinë e popullit, dhe mbi të gjitha, që është edhe lajtmotivi i gjithë librit poetik, PËR BASHKIMIN E TROJEVE SHQIPTARE, NË NJË SHTET TË VETËM, rruga që do ta çojë Shqipërinë në podin e Lavdisë e të Krenarisë që e ka pasur dikur midis shoqeve të kontinentit evropian.

Autori i librit, ndonëse gjendet në izolim, me shumë vite ndalimi, për asnjë çast nuk e ka humbur besimin tek vitaliteti i kombit të tij, dhe as shpresën se shumë shpejt ai do ta gjejë rrugën e vërtetë të zhvillimit, prosperimit dhe ribashkimit, ëndrra shekullore e shqiptarëve, që nga rilindësit e mëdhenj, e gjer tek luftëtarët e UÇK-së së lavdishme e Komandantit të saj legjendar Adem jashari.

Libri është njëherësh edhe një apel

të cilat e thërrisin.

Si në jetë, ashtu edhe në vdekje.

Me ato unaza në zemër Ndoc Mulaj dha trup në zemër të maleve tona, në Munellë, diku mes Mirditës dhe Pukës. Dha trup dhe fitoi shpirt, siç do të mund të thoshte dom Gjergj Meta, të cilin Ndoci e kishte ftuar ta bënte atë ngjitje në Munellë bashkë me ne atë ditë dramatike të 30 dhjetorit.

Trupi i Ndocit ra dhe shpirti ju ngjit lart, bash poshtë Majës së Kryqit në malin e Munellës. Tek i shihja kryqin dhe rruazën sot mes duarve të pajeta, tek më kujtoheshin bisedat me të, me njëfarë dyshimi për fenë, nuk mund të mos më vizitojë një maksimum nga Bibla, ku Zoti i drejtohet njeriut: Ti që nuk ke marrë pjesë në krijimin tënd, si mund të mos më kërkosh të jem në shpëtimin tënd.

Ndoci u nda nesh fizikisht, por na la mistikën e maleve të tij, praninë e maleve tona. Siç shkruante vetë në një postim të të 15 nëntorit të këtij viti:

*Kur të vdes, le të bahem bar,  
në malet e mia në pranverë,  
në vjeshtë do të bahem farë.  
Kur të vdes, le të bahem ujë,  
e fryma ëme avull,  
në fushë do të bie shi.  
Kur të vdes, le të bahem gur,  
në skajin e vendit tim,  
të qindroj kufi.  
Martin Camaj*

Ndoc Mulaj u kthehet maleve të veta, cilat ia dhanë jetën, por në një moment befasi edhe ia morën. Ai mund të kishte vdekur në shtrat nga zemra, por zgjodhi të vdiste aty ku kishte zemrën.

Sa herë të dal në male, unë do t'i thërras. në majekrahin e fiseve tona të Veriut: “O tunjatjeta, o Ndoc Mulaj, more heecheehheeejjjjjjjjjjjjj!”

për politikanët dhe pushtetarët e të dy shteteve shqiptare, veçanërisht për ata të Republikës së Kosovës, të cilët, ndërsa po përjetojnë e gëzojnë për fitoren dhe lirinë e fituar, kanë lënë mënjanë dhe jashtë kujdesjes shoqërore e shtetërore, shumë nga personazhet e kësaj fitoreje dhe kësaj lirie, disa prej të cilëve dhanë gjakun dhe jetën e tyre, apo u sakatuan në përpjekjet luftarake me pushtuesin barbar. Në këta personazhe të sakrificës, bën pjesë edhe Komandant Genc Sefa-“Lushnja”, i cili, së bashku me shokë të tjerë të luftës, falë mangësive, e madje edhe akrobacive të drejtuesve politikë e ushtarakë të Ushtrisë Çlirimtare, gjenden në burgun politik të shtetit sllavo-maqedonas.

Është e pafalshme për politikanët shqiptarë të Maqedonisë së Veriut, disa prej të cilëve edhe në përbërje të parlamentit dhe të qeverisë maqedonase, që edhe mbas gjashtë viteve nga ngjarjet në Kumanovë, nuk kanë bërë asnjë lëvizje politike apo ligjore, për të sqaruar si duhet se çfarë dhe pse ndodhi konflikti

luftarak, ku humbën jetën një shumë qytetarësh nga të dyja palët, duke synuar, që ashtu siç janë marrë e po merren vesh për probleme të tjera me politikanët dhe pushtetarët maqedonas, të gjenin mënyra për mbylljen edhe të konfliktit të datës 9 maj 2015 në “Lagjen e Trimave” të qytetit të Kumanovës.

Në mbyllje të këtyre shënimeve të thjeshta, uroj që autori i librit, Luftëtari e komandanti i Luftës Çlirimtare të Kosovës, Genc Sefa – Lushnja, të arrijë të shohë sa më parë ditën e lirisë, për të vijuar në kushte normale e krahas shokëve, veprimtarinë e tij atdhetare, por edhe atë letrare dhe artistike. Qëndresa e palëkundur dhe vijimi i veprimtarisë atdhetare edhe në kushtet e izolimit, na krijojnë besimin, se ai do të vijojë me vendosmëri në rrugën e lavdishme për çlirimin e trojeve tona dhe realizimin e Bashkimit Kombëtar.

Gjon Bruçi,  
studiuues e publicist

# KRONIKA E NJË DITE TË VEÇANTË!

U krye me shumë sukses. Ashtu si e meritojnë Heronjtë e Atdheut, ashtu si e meritojnë Dita e Pavarësisë. Konferenca historike "Adem Jashari: Simbol i qëndresës, frymëzues i lirisë", u mbajt në prestigjiozin Teatri Mbretëror "Namur", në praninë e 920 bashkëatdhetarëve dhe të ftuarve të nderit. Ajo u mbajt nga Shoqata "Nënë Tereza" Namur me President Z. Adnan Rexhepi, dhe organizator të Konferencës Z. Arian Bajraktari, si dhe u drejtua nga oratorët Deli dhe Denajda Bajraktari. Nxënësit, studentët, mësuesit e shkollës shqipe "Faik Konica" Namur, vunë në skenë me shumë emocione aktin "Përjetësia e Familjes Jashari". Vlen të përmendet puna e palodhur e mësuesve Elsa Haskurti, Anila Celami, Gentiana Aziri, Muhamet Bektashi, në realizimin e aktit skenik. Aktrimi i Artistit të famshëm Cun Lajçi në skenë, elektrizoi Teatrin me intepetimet e tij patriotike, duke frymëzuar dhe dhënë emocione të shumta. Fjala e hapjes u mbajt nga Z. Adnan Rexhepi, i cili falenderoi pjesëmarrësit dhe tregoi mbi aktivitetet kulturore, humane, sportive të përditshme të Shoqatës "Nënë Tereza" Namur, duke e ftuar komunitetin shqiptar të marrin pjesë, dhe të jenë sa më aktiv kundër rrezikut të asimilimit. Me interes ishte fjala përshëndetëse e mikut të shqiptarëve, Bougmestre de Namur Maxime Prevot, i cili theksoi urat e bashkëpunimit mes komuniteteve dhe bashkëpunimin me Prishtinën, dhe së fundmi me Bashkinë Malësi e Madhe. Me theksin e bashkimit kombëtar, prezantimin e programit të Konferencës dhe prezantimin e gjithë Ligjëruesve dhe Artistëve pjesëmarrës, e paraqiti para publikut ideatori i Konferencës Arian Bajraktari. Prof. Dr. Nusret Pllana, ligjëruesi kryesor në Konferencë, shtjelloi shkaqet, spastrimet, krimet monstruoze të gjakatarëve serb, dhe genocidin e ushtruar ndaj shqiptarëve në trojet e tyre etnike gjatë shekullit të kaluar dhe spjegoi rrethanat dhe kushtet se si lindi, luftoi dhe e fitoj betejën Ushtria Clirimitare e Kosovës me Komandant Adem Jasharin, dhe me Simbolin e tij deri në çlirimin përfundimtar. Theksojmë se Ligjërata ishte e përgatitur me shumë vëmendje e përkushtim në nivel Akademik nga Prof. Dr. Nusret Pllana, dhe u prezantua para publikut të shumtë, të shoqëruar edhe me imazhe të Power-Point. Prof. Dr. Nusret Pllana ka meritën e jashtëzakonshme, se si askush tjetër ka dokumentuar, denoncuar dhe botuar në mbi 8 gjuhë, dhunën, krimet barbare dhe genocidin e ushtruar ndaj popullit shqiptar nga regjimi serb ndër shekuj. Ishgazetari i periudhës së luftës, sot Deputet Federal, z. Michel De Maegd, i cili kishte ndjekur në direkt zhvillimet e luftës por edhe dramën e refugjatëve viktimë të spastrimit etnik, referoi në direkt me një kujtesë të mahnitshme, rrezikun, dramën civile, emocionet, përplasjet në terrenin e luftës. Power-Point që shoqëroi referatin e

tij, ishte i mbushur me foto të kohës, dramë humane por edhe me foto të fitores dhe gëzimit të lirisë, duke dhënë një emocion dritërues të pranishmit. Në fjalën e tij, qartë ndjehej simpatia për popullin shqiptar, dhe respekti i lartë për dinjitetin e treguar nga populli shqiptar në ato vite të vështira. Prof. Lukë Junçaj, i ardhur nga USA posaçërisht për të nderuar Familjen Jashari në Ligjëratën e tij, tregoi më së miri gjithë atë punë titanike të bërë nga mërgata jonë në USA, kryesisht ajo nga Malësia e Madhe. Lobimin e fuqishëm pranë Institucioneve të USA dhe kordinimin pa dallim feje në denoncimet dhe protestat antiserbe në një periudhë 50 vjeçare, duke sensibilizuar opinionin internacional diplomatik dhe qytetar, mbi atë çka po ndodhte në Kosovë. Referati i tij me një nivel të lartë intelektual, ishte edhe me emra konkret që nga fillimi i sensi-



bilizimit dhe deri në furnizimin me armë dhe vlera njerëzore, monetare, materiale të UCK, duke vlerësuar punën e kontributin e çdo patrioti në këtë kauzë të drejtë. Nuk mund ti mungonte kësaj Konference edhe përfaqësuesi i Familjes martire Jashari. Në fakt Prof. Dr. Murat Jashari, erdhi posaçësisht nga Kosova për të përshëndetur punimet e Konferencës, Referuesit dhe publikun e shumtë. Ovacionet, respektin dhe mirënjohjen ndaj kësaj Familjeje të nderuar, publiku e manifestoi me ovacione dhe duartrokime të përzemërta. Pas shpërdarjeve të stimijve moral për Konferencierët dhe dhënies së Titullit të Nderit "Nder i Mërgatës" nga drejtuesit e Shoqatës "Nënë Tereza" Namur, kjo ditë e paharruar do merrte një dimension të ri, atë të spektaklit. Konferenca mbahej me 28 nëntor, Ditën e Pavarësisë, ditën e flamurit por edhe ditëlindjes së Heroit Adem Jashari dhe themelimit të UCK. Leonora Jakupi, me më të bukurën e arsenalit të saj shpalosi mbi skenë këngët patriotike, duke ngritur peshë zemrat e bashkëatdhetarëve tanë të pranishëm, dhe duke ngazëlluar ambientin me festivitete. Nga thellësitë e Alpeve shqiptare, aty ku bora qëndron edhe në verë, nga Kelmendi i bukur, kishte ardhur grupi folklorik "Xhubleta e Alpeve Shqiptare". Eposi i kresh-

nikëve malësor ishte prezent në një nga skenat më prestigjioze të botës. Kënga maje krahu, që vjen nga kultura jonë e lashtë pagane e kësaj treve që nga koha Pellazgjike. Kënga me lahutë kushtuar Adem Jasharit, Vallja e Logut, kërcimi i shpatave realizuar të gjitha mjeshtërisht nga Luigj Gjerkaç, Rita Kalaj, Lorenc Smajlaj, Fatjonë Gjerkaç, Anxhela Shkurtaç, dhanë emocione të shumta e të paharrueshme. Por kësaj skene prestigjioze ju prezantua me gjithë madhësinë dhe bukurinë e saj Xhubleta, kjo pasuri e vyer etnografike 4000 vjeçare e trashigimisë sonë kulturore, e cila është kandidatë për njohjen nga UNESCO. Theksojmë punën e palodhur sensibilizuese në ruajtjen dhe promovimin e Xhubletës, nga zonja Rita Kalaj. Prezenca e Kryetarit të Bashkisë Malësi e Madhe, z. Tonin Marinaj, i cili e përshëndeti publikun e shumtë,

Universitet të Belgjikës, realizoi në direkt portretin e Heroit Adem Jashari, përfimet e së cilës shkuan për një familje në nevoja imediate. Mjeshtria dhe talenti në direkt, i birit të ndjerit piktorit Ilir Biçaku, tërhoqi shumë vëmendje dhe kureshtje nga publiku prezent. Por gjithë ku Event i jashtëzakonshëm në mbarëvajtjen e tij, u mbështet fuqishëm nga patriotët e heshtur, ato që e mbështetën materialisht dhe financiarisht të cilët po i rendisim sipas kontributit. Falenderim për Liridon e Fitim Sadiku (LS Automobile), Cem dhe Arta Umit (Le Metropole), Rexhep Mata (Albasol), Denis Sulejmani (La maison de l'assurance et du crédit), Xhavid Rexhepi dhe Zejdi Etemi (Illyria Construction), Esad Krasniqi dhe Bekim Mulaj (Be Façade), Agron dhe Safet Aliu (Brasserie du Théâtre), Qani Jusufi (La Charbonnade), Erduan Jakupi (Friterie Roger), Rami Avdiu (Era Trans), Burim Tërshana (Boucherie Tërshana), Berkan Sevimler (Sevimler Market). Bashkëpunimi i Shoqatës Studentore Shqiptare në Belgjikë "VLERA" dhe Shoqata "Lokja" me presidentë Suela Mehmetaj, ishte i lartë, çka përfitojmë nga rasti edhe ti falenderojmë për kontributin e dhënë. Stimuj të personalizuar me motivacion përkatës për kontributin e dhënë, ju dhanë secilit anëtar të grupeve folklorike, këngëtarëve, aktorëve, sponsorëve nga kryesia e Shoqatës dhe organizatori. Këtu merr fund kjo ditë maratonë. Konferencë dhe festivitete, në kushtet e një higjene të rreptë me kushtet pandemike. Falenderojmë për pjesëmarrjen në Konferencë ju të dashur bashkëatdhetarë për qytetarinë e lartë të treguar, pjesëmarrësit Belgj të shumtë në numër, përfaqësuesin e Familjes Jashari Prof. Dr. Murat Jashari, Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë, Znj. Suela Janina, Ministren Fuqplotë të Misionit Evropian, Znj. Lea Kallogjeri, Konsullin e Republikës së Kosovës, Z. Miftar Kryeziu, Deputetin Paulin Sterkaj, Deputetin Federal, Michel De Maegd, Kryebashkiakun e Malësisë së Madhe Z. Tonin Marinaj, Bougmestre De Namur, Mr Maxime Prevot, personalitetet e larta të kulturës vendore, Shoqatat e shumta kulturore... Ju jemi mirënjohës. Duam të falenderojmë përzemërsisht edhe një herë Ligjëruesit tanë, prezantuesit, aktorët, këngëtarët, grupet folklorike, nxënësit dhe mësuesit e shkollës shqipe "Faik Konica" për aktrimin dinjitoz, sponsorët tanë të nderuar, të ftuarit e nderit dhe gjithë atyre që kontribuan në mbarëvajtjen e këtij Eventi të përmasave në Mërgim. Shihemi në veprimtrinë e radhës... Mirupafshim!

**Arian Bajraktari**  
Bruksel

Mundësoi Botimin:  
**NIKO MARKU**



## REDAKSIA

Kryeredaktore: **LUIGJ SHYTI**

Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.